



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 4569 prot.

Shkodër, më 17.12.2025

**V E N D I M**

Nr. 335, datë 17.12.2025

**"Për miratimin e Raportit Vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore dhe  
financiare të USH-së për vitin akademik 2024-2025"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 32, 38; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, germa II; Udhëzim nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të IAL-ve", i ndryshuar, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, në mbledhjen e përbashkët të datës 17.12.2025

**Vendosi:**

1. Të miratojë Raportin Vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore dhe financiare për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin e Shkodrës, "Luigj Gurakuqi", (bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**  
**AKADEMIK**

Prof. Dr. Tonin GJURAJ



**KRYETARI I BORDIT**  
**TË ADMINISTRIMIT**

Prof.Asoc.Dr.Adrian LEKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

**RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË MËSIMORE DHE SHKENCORE PËR VITIN  
AKADEMIK 2024 – 2025 NË UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

**Shkodër, 2025**

## Përmbajtja

|                                                                                                                                                                                                                            |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| A. SENATI AKADEMIK.....                                                                                                                                                                                                    | 4  |
| i .Fusha Mësimdhënia .....                                                                                                                                                                                                 | 5  |
| Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies. ....                                                                                                                                                                               | 5  |
| Objektiva të përgjithshëm .....                                                                                                                                                                                            | 6  |
| ii. Fusha Kërkimi Shkencor dhe Veprimtaria Krijuese dhe Inovacioni .....                                                                                                                                                   | 20 |
| ii) Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien.....                                                                                                                                                          | 40 |
| iv) Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor .....                                                                                                                                                     | 52 |
| d-Të dhëna mbi programet e studimit .....                                                                                                                                                                                  | 54 |
| e. Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. ....                                                                                                 | 61 |
| f-Parashikimi për angazhimin e personelit akademik, ngarkesa përkatëse, lëndën/t, dhe/ose moduln/et që do të zhvillojë secili prej tyre, për secilin semestër të vitit akademik. ....                                      | 68 |
| g) Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar: ..... | 78 |
| h) Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë .....                                                                      | 80 |
| vi) pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre; .....                                                                                                        | 81 |
| e) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare. ....                                                                                   | 83 |



## **Treguesi i tabelave**

**Tabela nr. 1: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies**

**Tabela nr. 2: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit**

**Tabela nr. 3: Mbi bashkëpunimin institucional**

**Tabela nr. 4: Mbi projektet e kërkimit shkencor në të cilat IAL ka aplikuar për financim**

**Tabela nr. 4.2: Pjesëmarrje në borde editoriale dhe projekte 2024 - 2025**

**Tabela nr. 4.3: Pjesëmarrjet në konferenca dhe botimet e stafit akademik për vitin akademik 2024-2025**

**Tabela nr. 5: Mbi aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara**

**Tabela nr. 5.1 Pedagogët të cilët kanë marrë grada dhe tituj gjatë vitit akademik 2024-2025**

**Tabela nr. 6: Mbi infrastrukturën e kërkimit shkencor**

**Tabela nr. 7: Mbi programet e studimit**

**Tabela 8. Mbi veprimtarinë e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë**

**Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik**

**Tabela nr. 10: Për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet**

**Tabela nr. 11. Mbi përbërjen e Këshillave Studentorë**

**Tabela nr. 12. Mbi studentët që kanë qenë anëtarë dhe përfaqësues në organet e IAL-së**

**Tabela nr. 13. Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve**

**Tabela 14. Mbi numrin e studentëve të crregjistruar dhe të transferuar**

**Tabela nr. 15: Mbi numri i studentëve të ciklit të parë që përfitojnë bursë sipas VKM nr.903,datë 21.12.2016 (përditësuar) të ndara sipas kriterëve**

**Tabela nr. 16: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që paguajnë tarifë ( 50% ose 100%) sipas VKM nr. 288, datë 21.05.2018 (përditësuar) të ndarë sipas kriterëve**

**Tabela nr. 17: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017 të ndarë sipas kriterëve**

**Tabela nr. 18: Mbi numrin e studentëve të ciklit të dytë që paguajnë tarifë (50 %) të ndarë sipas kriterëve të VKM nr. 780, datë 26.12.2018**

**Tabela nr. 19: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre.**

**Tabela nr. 29: Mbi mobilitetin e personelit akademik**

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", si institucion publik, ka kryer analizën e veprimtarisë së procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe gjendjen financiare gjatë vitit akademik 2024-2025, e cila paraqitet në këtë raport. Raporti paraqet në mënyrë të detajuar drejtimet në të cilat është zhvilluar veprimtaria e njësive dhe sektorëve përbërës të këtij institucioni, që janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore të institucionit. Raporti synon të evidentojë drejtimet kryesore që përfshijnë veprimtarinë e organeve vendimmarrëse, hapjen e programeve të reja dhe qëndrueshmërinë e programeve tashmë në funksion, prurjet e reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përshtatshmërinë e rregulloreve të programeve të studimit më kërkimet e tregut të punës në rajonin e Shkodrës e më gjerë, ngarkesat mësimore dhe burimet e literaturës, si dhe drejtimet kryesore të aktivitetit kërkimor dhe shkencor të stafit akademik të universitetit.

#### ***Baza ligjore e hartimit të raportit***

Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" Neni 32

Udhëzimi Nr. 5, dt. 19.12.2018, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë" ndryshuar me udhëzimin nr. 24 datë 21.10.2019.

Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rregullore e Studimeve të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Standartet Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (ASCAL, Tiranë 2018).

#### ***Materiale ndihmëse për hartimin e raportit***

Udhëzuesi "Për modelin e raportimit vjetor të institucioneve publike të arsimit të lartë, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të ministrit të Arsimit dhe Sportit", me shkresë përcjellëse

Nr. 75/5 prot. Datë 31.07.2023 i MAS

Tabelat shoqëruese të Udhëzuesit

Raporti i Monitorimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", hartuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit Nr. Prot 4505\6, datë 25.09.2024

#### ***Dokumentet e USH-së të përfshira në raport***

Raportet e analizave të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në departamente, materialet përmbledhëse të hartuara nga dekanët e njësive kryesore

Raportet e Vlerësimit të Brendshëm të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Raporti i sekretarive mësimore

Raporti i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët

Raporti i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit

Raporti përfundimtar përfshin materialet e mësipërme dhe hartohet nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit.

## A. SENATI AKADEMIK

**a. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.**

### i .Fusha Mësimdhënia

**Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies.**

Procesi i mësimdhënies në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” mbështetet në “Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” 2022-2026” që aspirojnë të:

- a) të plotësojnë aspiratat e studentëve duke iu mundësuar arritjen e plotë të potencialit të tyre;
- b) të sigurojnë një arsim cilësor dhe me vlera për të gjithë studentët duke iu siguruar atyre zhvillimin e kompetencave, etikës, vlerave qytetare të cilat do t'u shërbejnë në jetë dhe karrierë;
- c) të zhvillojnë partneritete të qëndrueshme me IAL-të dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkimit dhe të mësimdhënies;
- d) të kontribuojnë në mënyrë efektive në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike në vend dhe në rajon;
- e) të ketë një staf akademik konkurrues në treg, duke i siguruar mundësi të barabarta rekrutimi, zhvillimi personal dhe avancimi në karrierë.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 USH-ja ka pasur disa qëllime dhe objektiva të realizuara përmes disa komponentëve.

Për ciklin e parë Bachelor një nga qëllimet kryesore ka qenë formimi i studentëve me njohuri të përgjithshme bazë në fusha të ndryshme, si: gjuhë e letërsi shqipe dhe gjuhë të huaja; albanologjia; shkencat e natyrës e ato me drejtim infermierik, shkencat e edukimit dhe ato sociale, drejtësia, ekonomia me disa drejtime etj.), realizuar përmes:

- përditësimit të leksioneve,
- shfrytëzimit të një literature bashkëkohore,
- shtjellimit të materialeve teorike,
- trajtimit shkencor të argumenteve të prezantuara,
- bashkëpunimit student/pedagog;
- përfshirjes në mënyrë interaktive në orët teorike të menduarit kritik dhe gjenerimit dhe të zhvillimit e ideve etj.;
- përfshirjes së metodave bashkëkohore të bazuara në teknologji
- krijimit të një mjedisi akademik gjithëpërfshirës;

Për ciklin e dytë Master dhe Programe të integruara është synuar:

- Formimi i studentëve me njohuri të thelluara në fushat e ndryshme - realizuar përmes përdorimit të literaturës bashkëkohore;
- Aftësimi i studentëve për të trajtuar, për të vlerësuar, për të analizuar dhe interpretuar çështje të ndryshme-realizuar përmes trajtimit shkencor dhe nxitjes së debatit dhe të diskutimit, lidhur me çështje aktuale në fushat përkatëse;
- Thellimi i aftësisë për të punuar në grup duke nxitur një shkallë të lartë autonomie dhe përgjegjësie, personale dhe profesionale, në koordinim edhe me operatorët e tjerë profesionalë ndërveprues-realizuar përmes punëve në grup, detyrave të kursit, pjesëmarrjes në projekte e konkurse etj.

Programet nga fusha e mësuesisë kanë synuar:

- Formimin profesional të studentëve për procesin e mësimdhënies në fusha, si edukimi (me fokus përgatitjen e mësuesve për ciklin fillor), përgatitja e mësuesve të gjuhës shqipe dhe gjuhëve të huaja, përgatitjen e mësuesve të historisë e gjeografisë, biologjisë e kimisë, matematikës e fizikës etj.- realizuar me anë të formimit të aftësive krijuese dhe garantimin e cilësisë në mësimdhënie.
- Pajisen e studentëve me njohuri bashkëkohore rreth mësimdhënies-realizuar përmes diskutimeve, punëve në grup në lidhje me punën e mësuesit, projekteve etj.

Të gjithë fakultet kanë synuar që gjatë vitit akademik 2024-2025 të përfshijnë në procesin e akreditimit të programet e studimit të paakredituara, si dhe hapjen e programeve të reja të studimit.

## Objektiva të përgjithshëm

**Fakulteti i Shkencave Shoqërore** ka si synim:

1. Rritjen e vazhdueshme e cilësisë akademike me objektiv një mësimdhënie sa më cilësore, që bazohet në metoda të avancuara dhe mjete teknologjike moderne. Në funksion të realizimit të këtij objektiv do të kemi parasysh përdorimin e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies (mjete interaktive), përditësimin e vazhdueshëm të materialeve didaktike, trajnimin e pedagogëve dhe njohjen e tyre me metodat moderne të mësimdhënies dhe përdorimin i mësimdhënies aktive me fokus studentin.
2. Zhvillimin e aftësive kritike dhe profesionale të studentëve, duke u mundësuar atyre të përshtaten me kërkesat e tregut të punës dhe të bëhen liderë në të ardhmen në fushat e tyre. Në funksion të kësaj do të jetë angazhimi i studentëve në aktivitete praktike dhe internshipe, organizimi i seminareve dhe i diskutimeve mbi tema aktuale të fushave të ndryshme dhe mbështetje për zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik.
3. Përforcimin e ndërveprimit ndërmjet kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, me objektiv krijimin e një lidhjeje më të ngushtë midis tyre, duke ofruar mundësi për studentët dhe pedagogët që të kontribuojnë në kërkime kombëtare dhe ndërkombëtare. Në funksion të kësaj do të kemi në fokus organizimin e grupeve kërkimore, angazhimin e studentëve në projekte

shkencore, krijimin e mundësive për botimin e punimeve kërkimore nga pedagogët e studentët dhe mbështetje për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete shkencore.

4. Përmirësimin e shërbimeve dhe të mbështetjes së studentëve, me objektiv realizimin e një mjedisi sa më atraktiv për ta. Në funksion të saj do të jetë zhvillimi i shërbimeve për orientimin dhe këshillimin e studentëve, mbështetje për studentët me nevoja speciale, zhvillimi i aktiviteteve kulturore etj..

5. Ndërkombëtarizimin e mësimdhënies, që është një nga objektivat e konsideruara tashmë si sfidë e kohës, duke krijuar mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar, në mënyrë që studentët dhe pedagogët të përfitojnë nga përvoja ndërkombëtare. Kjo do të mundësohet me krijimin e hapësirave për mobilitetin e tyre, nga bashkëpunimi me universitete të tjera, përkthimi i materialeve mësimore në gjuhë të ndryshme etj.

6. Zhvillimin e programeve të studimit që përmbushin kërkesat e tregut të punës, me objektiv kryesor që programet tona të përputhen me nevojat e tregut të punës. Kjo do të mundësohet nga përditësimi i programeve të studimit në përputhje me kërkesat e këtij tregu apo nga përfshirja e ekspertëve të fushave të ndryshme në procesin e mësimdhënies.

7. Përmirësimin e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, objektiv që do të mundësohet nga përdorimi i mjeteve në funksion të rritjes së efektivitetit në këtë proces, duke synuar të jemi sa më fleksibël.

8. Krijimin e një sistemi të vlerësimit dhe të feedback-ut që duhet të marrin pedagogët e studentët në të njëjtën kohë, me objektiv krijimin e një sistemi të qartë dhe të drejtë të vlerësimit, që do të ofrojë mundësi për një zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm të tyre.

9. Krijimin e një mjedisi akademik gjithëpërfshirës dhe të diversifikuar, duke ofruar mundësi për të gjithë studentët pa dallim.

10. Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

11. Rishikimi i *syllabus*-eve të lëndëve.

12. Rishikimin dhe plotësimin e leksioneve dhe përgatitjen për printim ose botim.

13. Përmirësimin e cilësisë së programeve mësimore.

14. Përmirësimin e vlerësimit të performancës mësimore.

15. Bashkëpunimin me sektorin privat për zhvillimin e kurrikulës etj.

16. Të gjitha këto objektiva janë pasur parasysh në të gjithë procesin e punës në njësitë bazë të FSHSH e, në mënyrë të veçantë, në procesin e hartimit të kurrikulave në programet e të tre cikleve të studimit.

**Fakulteti i Shkencave të Natyrës** synon të sigurojë:

- Ngritjen cilësore të mësimdhënies, duke inkurajuar dhe mbështetur zhvillimin profesional të stafit akademik përmes kualifikimeve të mëtejshme, fitimit të titujve dhe gradave shkencore, si dhe përfshirjes së tyre në projekte kërkimore, aktivitete shkencore dhe publikime.
- Rritjen e përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor, me qëllim stimulimin e mendimit kritik, aftësive analitike dhe formimit të kompetencave profesionale të orientuara drejt tregut të punës.

- Rritjen e cilësisë dhe të konkurrueshmërisë të diplomave, duke i bërë ato të krahasueshme me standardet evropiane dhe të kërkuara në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.
- Hapjen dhe zhvillimin e programeve të reja të studimit, të cilat adresojnë nevojat aktuale të tregut, tendencat shkencore dhe teknologjike, si dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik dhe social.
- Zbatimin e standardeve të larta në vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit, në përputhje me kërkesat e Kuadrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Objektivat e strategjisë së mësimdhënies përfshijnë krijimin e një strukture akademike të mirëkualifikuar, inovative dhe të orientuar drejt ekselencës, e cila u ofron studentëve një mjedis të sigurt akademik për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për sukses në karrierë dhe në jetën profesionale.

#### **Fakulteti i Shkencave të Edukimit synon dhe ofron:**

- Kurrikula të pasura dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, (Cikli I dhe Cikli II), në zbatim të Deklaratës së Bolonjës, legjislacionit për Arsimin e Lartë dhe udhëzimeve të MA-së, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë e nevojshme praktike.
- Staf akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, profesionalizëm dhe përkushtim të tij.
- Nivel të lartë të punës kërkimore - shkencore të pedagogëve dhe të aktivitetit të tyre botues.
- Monitorim i përvitshëm i cilësisë së mësimdhënies.
- Numër të lartë aktiviteteve të realizuara nga pedagogët me student.
- Marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes lokale dhe shërbimet e ofruara nga OJF-të, ku zhvillohen praktikat profesionale të studentëve.

#### **Bashkëpunim të vazhdueshëm të FSHE-së me komunitetin akademik, e më e gjerë.**

- Zhvillimin profesional i stafit akademik.
- Hapjen e programeve të reja.
- Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet partnere etj.

#### **Fakulteti i Drejtësisë**

Fakulteti i Drejtësisë, ka si prioritet ofrimin e një mësimdhënie cilësore e bashkëkohore dhe bazuar mbi këtë, stafi akademik i Fakultetit ka demonstruar angazhim të vazhdueshëm në rritjen e cilësisë së kurrikulave, nëpërmjet përditësimit të programeve mësimore, zgjerimit të komponentëve praktikë dhe përfshirjes së qasjeve ndërdisiplinore. Vërehet se procesi mësimor zhvillohet kryesisht duke aplikuar metoda bashkëkohore, interaktive dhe të orientuara drejt studentit, të cilat mundësojnë ndërthurjen e bazave teorike me ato praktike, forcimin e kompetencave profesionale të studentëve, si dhe krijimin e një ambienti mbështetës akademik.

Metodat e përdorura kanë synuar rritjen e interaktivitetit, nxitjen e mendimit kritik dhe përfshirjen në diskutime praktike, duke krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve.

Megjithatë, vihet re se mungesa e literaturës së përshtatshme të vënë në dispozicion për pedagogët dhe studentët, si dhe në disa raste pamjaftueshmëria e kushteve optimale për zhvillimin e leksioneve, krijojnë hapësirë për vështirësi të herëpashershme në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në këtë kuadër, një ndër çështjet kryesore që evidentohet është numri i kufizuar i sallave, i cili shpesh ndikon në përcaktimin e orareve të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve dhe të seminareve.

Stafi akademik ka nënvizuar domosdoshmërinë e përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse të procesit mësimor, përfshirë përmirësimin e cilësisë së aksesit në internet dhe vënien në dispozicion të pajisjeve që mundësojnë përdorim më të avancuar të teknologjisë dhe të metodave inovative të mësimdhënies.

Gjithashtu, është theksuar nevoja për sigurimin e botimeve më të fundit sipas programeve të lëndëve, krijimin e mundësive për akses apo abonim në revista shkencore ndërkombëtare dhe librari të ndryshme digjitale të fokusuara në fushën e së drejtës.

Këto sfida shpesh i kanë vendosur pedagogët në kushte të vështira për të arritur rezultatet optimale në cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Përditësimi i programeve mësimore dhe përshtatja e kurrikulave me standardet evropiane të arsimit të lartë dhe me kërkesat e tregut të punës, duke i dhënë rëndësi zgjerimit të komponentëve praktikë.

Ky fakultet ka pasur si qëllim:

- Përfshirjen e qasjeve ndërdisiplinore.
- Integrimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me fokus kryesor studentin. Metoda interaktive dhe të orientuara drejt studentit, të cilat mundësojnë ndërthurjen e bazave teorike me ato praktike, forcimin e kompetencave profesionale të studentëve, si dhe krijimin e një ambienti mbështetës akademik.
- Përdorimin e mjeteve digjitale dhe laboratorike moderne për rritjen e përvojës praktike të studentëve.
- Sigurimin e cilësisë dhe vlerësimi i mësimdhënies- realizuar përmes anketimit të studentëve.
- **Ngritjen cilësore të mësimdhënies**, duke inkurajuar dhe mbështetur zhvillimin profesional të stafit akademik përmes kualifikimeve të mëtejshme, fitimit të titujve dhe gradave shkencore, si dhe përfshirjes së tyre në projekte kërkimore, aktivitete shkencore dhe publikime.
- **Rritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së diplomave**, duke i bërë ato të krahasueshme me standardet evropiane dhe të kërkuara në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.
- **Hapjen dhe zhvillimin e programeve të reja të studimit**, të cilat adresojnë nevojat aktuale të tregut, tendencat shkencore dhe teknologjike, si dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik dhe social.
- **Zbatimin e standardeve të larta në vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit**, në përputhje me kërkesat e Kuadrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

**Fakulteti Ekonomik**



Gjatë vitit akademik 2024-2025 është kryer përditësimi i *syllabus*-eve, të tre departamenteve në FE, sipas rekomandimeve të lëna nga akreditimi i programeve Bachelor dhe ka realizuar objektivat strategjike në lidhje me mësimdhënien, duke përfshirë:

- Garantimin e cilësisë së programeve Bachelor, duke marrë për herë të parë akreditimin e programeve Bachelor.
- Rritjen e cilësisë akademike dhe të standardeve të të nxëniet duke u përshtatur me kërkesat e tregut të punës, dhe duke përshtatur kurrikulat sipas zhvillimeve të fundit ekonomike.
- Integrimin e literaturës dhe të metodave bashkëkohore të mësimdhënies.
- Forcimin e lidhjes teori-praktikë përmes rasteve studimore dhe bashkëpunimit me institucione publike dhe private, në sektorët: e financave, të kontabilitetit, të turizmit dhe në sektorin e administrimit të biznesit.
- Zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve (aftësi analitike, komunikim, etikë, përgatitje reale për tregun e punës).

#### **Përgatitja e materialeve mësimore dhe vlerësuese**

- Literatura bashkëkohore dhe seminare të strukturuar për secilën temë, sipas specifikave të departamenteve.
- Quiz-e periodike, ushtrime interaktive dhe teza provimesh të balancuara, që shërbejnë për matjen e progresit.
- Përdorim i artikujve shkencorë dhe rasteve studimore për lidhjen praktikë-teori, sipas profileve përkatëse.

#### **Vlerësimi i cilësisë dhe rezultatet akademike**

- Cilësia e procesit të mësimdhënies dhe të të nxëniet është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet instrumenteve të miratuara nga FE-ja dhe nga zyra e Standartizimit dhe Cilësisë në FE. Monitorim nëpërmjet pyetësorëve të studentëve. Pyetësorët e organizuar në nivel universitar për programet Financë – kontabilitet, Turizëm dhe Administrim-Biznes, janë në një shkallë të kënaqshme plotësimi. Departamenti Financë -Kontabilitet ka një pjesëmarrje shumë të lartë në plotësimin e pyetësorëve, dhe rreth 90% e të anketuarve për programet e këtij departamenti janë përgjigjur pozitivisht. Frekuentimi i studentëve në të trija degët është i mirë.
- Studentët me rezultate dhe performancë të mirë ka në programet Bachelor dhe Master dhe studentët kanë performancë më të lartë në nivelin Master. Në programet Master shkencor dhe profesional, niveli i angazhimit dhe cilësia e punimeve kanë qenë dukshëm të larta. Studentët kanë shfaqur aftësi të avancuara në kërkimin shkencor, përgatitjen e projekteve profesionale dhe aplikimin teorik të njohurive. Rezultatet e provimeve dhe të detyrave të kursit kanë qenë pozitive, duke përbushur objektivat e programeve të studimit sipas departamenteve në FE.

#### **Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

Programet e studimit të ciklit të parë Bachelor që ofrohen në FGJH bazohen në objektiva të shprehura qartë dhe që kanë objektiv:

- përmirësimin dhe perfeksionimin e njohurive gjuhësore, ku nëpërmjet lëndëve me karakter gjuhësor studentët duhet të aftësohen që të shprehin dhe interpretojnë në gjuhë të huaj, si me gojë



ashtu edhe me shkrim, koncepte, ide, ndjenja, fakte dhe mendime (në anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht)

- formimin e studentëve me njohuritë bazë shkencore të fushës së gjuhësisë, të letërsisë e kulturës së vendeve anglofone, të vendeve frankofone, të gjuhës, të letërsisë e kulturës italiane si dhe të gjuhës, letërsisë e kulturës së vendeve gjermanishtfolëse
- aftësimin e studentëve në fushën e translacionit, njohja me teoritë bazë si dhe të teknikave e strategjive që përdoren gjatë procesit të përkthimit si atij me shkrim ashtu edhe me gojë,
- aftësimin e studentëve në fushën e komunikimit ndërkulturor, të jenë të aftë të shprehin lirshëm arsyetimin logjik si dhe të zhvillojnë mendimin kritik mbi tema të ndryshme

Në të katër programet e ciklin e II të studimit Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Angleze, në Mësuesi Gjuhë Italiane, në Mësuesi Gjuhë Frënge e në Mësuesi në Gjuhë Gjermane misioni i mësimdhënies gjatë këtij viti akademik ka qenë që përmes disiplinave teorike bazë të fushës didaktike të gjuhës së huaj dhe të praktikave në shkollat e sistemit parauniversitar, të realizojë:

- objektivat formuese për përgatitjen e studentëve me shprehi shumë të mira si mësues të gjuhës angleze, italiane, frënge e gjermane.
- metodotat e mësimdhënies së gjuhës së huaj nëpërmjet platformave digjitale, p.sh nëpërmjet përdorimit të learning apps etj.
- orët reale të praktikave mësimore si një domosdoshmëri, ku njohuritë teorike duhet të gjejnë zbatim në praktikë dhe kjo përball studentët me realitetin e punës së mësuesit.

**Gjatë vitit akademik 2024-2025 prioritet ka qenë hapja e programeve të reja dhe riorganizimi i atyre ekzistuese.**

Është punuar për hapjen e disa programeve të studimit dhe ka ardhur miratimi për hapjen e programeve të reja, sidomos nga FSHN-ja, si “Infermieri Klinike” (ka filluar në vitin akademik 2025-2026), “Sigurimi i Cilësisë së Ushqimit dhe të Ushqyerit” ka filluar në vitin akademik 2025-2026).

Riorganizimeve nga fusha e mësuesisë.

Kalimi nga Master Profesional në Master Shkencor i programeve të studimit: “Mësuesi në Biologji-Kimi”; “Mësuesi në Matematikë-Fizikë”; “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Informatikë”; Master i Shkencave në “Mësuesi në Matematikë”, Master i Shkencave në Mësuesi në Gjuhë të Huaj-Gjuhë Italine, Gjuhë Angleze, Gjuhë Gjermane, Gjuhë Frënge.

**Tabela nr. 1: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies:  
Fakulteti i Shkencave Shoqërore**

| Nr | Plani dhe proceset e planifikuara                                          | Aktivitetet dhe detyrat konkrete                                                                                                                                         | Fakulteti/Drejtorja/Spektori përgjegjës                                                  | Realizimi sipas planit strategjik                              | Afati                          | Komente                                                                                                            |
|----|----------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|--------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1  | Rishikimi i Syllabuse të lëndëve                                           | Përditësimi i literaturës 5 vjet e fundit                                                                                                                                |                                                                                          | Pa                                                             | shtatori-nentor 2024           |                                                                                                                    |
| 2  | Rishikimi dhe plotësimi i leksioneve, përgatitja për print ose botim       | Secili pedagog lëndat perkutuese                                                                                                                                         |                                                                                          | pa                                                             | 2024-2025                      |                                                                                                                    |
|    | Përgatitja për botim 3 vëllime studimore                                   |                                                                                                                                                                          |                                                                                          | pa                                                             | 2024-2025                      |                                                                                                                    |
|    | Përmirësimi i cilësisë së programeve mësimore                              | Rishikimi i syllabuseve dhe përshatja me kërkesat e tregut të punës                                                                                                      | FSHSH, Departamenti i Gjeografisë                                                        | Syllabuse të rishikuara dhe të miratuara nga Senati            | Tutor-Nentor 2024              |                                                                                                                    |
|    | Procesi i akreditimit                                                      | Organizimi i trajnimeve për pedagogët për procesin e akreditimit                                                                                                         | Zyra e cilësisë / Njësia e trajnimeve                                                    | Trajnim i realizuar                                            | Mars-Prill 2025                |                                                                                                                    |
|    | Rritja e përfshirjes së studentëve në procesin mësimor                     | Zbatimi i projekteve praktike dhe punës në grup në lëndat me karakter aplikativ                                                                                          | Pedagogët e lëndëve                                                                      | Projekte të dorëzuara dhe vlerësime pozitive nga studentët     | Gjate vitit akademik 2024-2025 |                                                                                                                    |
|    | Përmirësimi i vlerësimit të performancës mësimore                          | Zhvillimi i mekanizmave të feedback-ut të studentëve dhe analiza e rezultateve të mesindhënieve                                                                          | Departamenti i Gjeografisë                                                               | Raporte vjetore të vlerësimit dhe masa për përmirësim          | Gjate gjithë vitit akademik    |                                                                                                                    |
|    | Nxitja e mesindhënieve gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunimit ndërdisciplinor | Organizimi i seminareve karakter ndërdisciplinor                                                                                                                         | Departamenti i Gjeografisë                                                               | Nga edo anëtar i Departamentit me pjesëmarrje ndërdisciplinore | Mars – Maj 2025                |                                                                                                                    |
|    | Përmirësimi i rezultateve të studentëve në provime                         | Analiza e rezultateve semestrale dhe përshatja e metodave të mesindhënieve                                                                                               | Stafi i Departamentit të Gjeografisë                                                     | Rritje e masurës së natës dhe ulje e përsëritjeve në provime   | Janar – Qershor 2025           |                                                                                                                    |
|    | Digitalizimi i materialeve mësimore                                        | Përdorimi i platformave online për shpërndarjen e materialeve dhe detyrave                                                                                               | Departamenti i Gjeografisë                                                               | Dërgimi në afatet e materialeve të leksioneve                  | Gjate gjithë vitit akademik    |                                                                                                                    |
|    | Shkëmbimi i praktikave të mirë pedagogjike                                 | Pjesëmarrje e 4 pedagogëve të departamentit të Gjeografisë në trajnimin e mesuesve të Gjeografisë në rajonin verior                                                      | ASCAI                                                                                    | U realizuan me sukses                                          | Janar-Qershor 2025             |                                                                                                                    |
|    | Bashkëpunimi me sektorin privat për zhvillimin e kurrikulës                | Workshop me operatorët turistikë për përshatjen e programeve me nevojat e tregut                                                                                         | Departamenti i Gjeografisë                                                               | Jane reflektuar sugjerimet e dala nga diskutimet               | Prill 2025                     |                                                                                                                    |
|    | Nxitja e kërkimit shkencor në mesindhënie                                  | Inkurajimi i publikimeve që lidhen me inovacionin në arsim                                                                                                               | Departamenti i Gjeografisë/Stafi akademik/Artikuj të botuar dhe prezantime në konferenca |                                                                | Gjate gjithë vitit akademik    |                                                                                                                    |
|    | Përmirësimi i cilësisë së mesindhënieve                                    | Organizimi i trajnimeve metodologjike për stafin akademik, rishikimi i programeve mësimore për t'i përshatatur me standardet bashkëkohore                                | Departamenti i Historisë / Fakulteti i Shkencave Shoqërore                               | realizuar                                                      | Dhjetor 2025                   | Programet janë realizuar plotësisht                                                                                |
|    | Zhvillimi i aktiviteteve studentore                                        | Organizimi i diskutimeve tematike dhe ditëve studimore me studentë                                                                                                       | Departamenti i Historisë / Fakulteti i Shkencave Shoqërore                               | Realizuar sipas planit                                         | Maj 2025                       | Aktivitetet kanë pasur pjesëmarrje të lartë dhe reague pozitive nga studentët                                      |
|    | Porëimi i praktikës mësimore dhe kërkimeve në terren                       | Zhvillimi i praktikave studimore në muze, arkivë dhe terren arkeologjik, bashkëpunim me institucionet lokale për projekte kërkimore                                      | Departamenti i Historisë / Fakulteti i Shkencave Shoqërore                               | Realizuar sipas planit                                         | Maj 2025                       | Studentët kanë kryer vizita studimore në disa muze në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe në terrene arkeologjike |
|    |                                                                            | Organizimi dhe realizimi i ekspediteve mësimore me studentë të programeve të studimit që mbulon Departamenti Historisë në qendrat historike në rajonin e Salento (Itali) | Departamenti i Historisë / Fakulteti i Shkencave Shoqërore                               | Realizuar sipas planit                                         | Prill-Maj 2005                 | Një eksperiencë e paharrueshme për studentët                                                                       |

## Fakulteti i Shkencave të Natyrës

*Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimthënies FSHN*

| Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për tashmë e mësimdhënies |                                                                                            |                                        |                                                                                         |                  |                                                                                                                                                                                                      |           |        |  |
|----------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------|--|
| Nr                                                                         | Plan dhe proceset e planifikuara                                                           | Aktivitet dhe detajet konkrete         | Fakulteti/Prirësit                                                                      | Drejtori/Sektori | Realizimi sipas planit strategjik                                                                                                                                                                    | Afati     | Koment |  |
| 1                                                                          | Hapja e programit Master i Shkencave në „Infermieri Klinike“                               |                                        | Departamenti i Klinikë                                                                  | i Lëndëve        | U realizua hapja e programit me urdhër 359 prot. datë 23.07.2025                                                                                                                                     | 2025      |        |  |
| 2                                                                          | Hapja e programit Master i Shkencave në “Mësuesi në Biologji-Kimë”                         |                                        | Departamenti i Kimisë                                                                   | i Biologji-      | U realizua hapja e programit me urdhër Nr.453, date 26.08.2024                                                                                                                                       | 2024      |        |  |
| 3                                                                          | Hapja e programit Master i shkencave në “Sigurimi i Cilësisë së Ushqimit dhe të Ushqyerit” |                                        | Departamenti i Kimisë                                                                   | i Biologji-      | U realizua hapja e programit me urdhër Nr.451, date 10.09.2025                                                                                                                                       | 2025      |        |  |
| 4                                                                          | Hapja e programit “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Matematikë-Fizikë”                   |                                        | Departamenti i Fizikës                                                                  |                  | U realizua hapja e programit me urdhër Nr.441, date 26.08.2024                                                                                                                                       | 2024      |        |  |
| 5                                                                          | Hapja e programit “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Informatikë”                         |                                        | Departamenti i Matematikës                                                              |                  | U realizua hapja e programit me urdhër Nr.452, date 26.08.2024                                                                                                                                       | 2024      |        |  |
| 6                                                                          | Hapja e programit “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Matematikë”                          |                                        | Departamenti i Matematikës                                                              |                  | U realizua hapja e programit me urdhër Nr.356, date 31.07.2024                                                                                                                                       | 2024      |        |  |
| 7                                                                          | Përmirësimi i infrastrukturës                                                              | i Krijim përmirësim dhe i laboratoreve | Departamenti i Kimisë                                                                   | i Biologji-      | Është duke u punuar për hapjen e laboratorit Klinik-Biokimik                                                                                                                                         | 2025      |        |  |
| 8                                                                          | Përditësimi i syllabuseve të lëndëve për vitin akademik 2024-2025                          | Rishikimi i literaturës                | Departamentet e FSHN                                                                    |                  | U realizua plotësisht                                                                                                                                                                                | 2024-2025 |        |  |
| 9                                                                          | Sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi i mësimdhënies                                           | Anketimi i studentëve                  | FSHN/ Dept i Klinikë, Dept i Lëndëve Paraklinike, Matematikës, Biologji-Kimisë, Fizikë. |                  | Studentët theksojnë si pikë që kanë nevojë të rishikohen janë: aspektet teorike të seminareve në lëndë të ndryshme, ndarjen e pikëve të vlerësimit të vazhduar, realizimi i praktikave profesionale. | 2024-2025 |        |  |

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

*Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies*

[illegible]**Fakulteti i Drejtësisë**

Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

| Objektivi I: Në funksion të aritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                          |                                         |                                   |           |                                           |
|---------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|-----------------------------------|-----------|-------------------------------------------|
| Nr                                                                        | Plasi dhe proceset e planifikuara                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Aktivitetet dhe detyrat konkrete                                                                                         | Fakulteti/ Drejtoria/Sektori përgjegjës | Realizimi sipas planit strategjik | Afati     | Komente                                   |
| I                                                                         | Diplomë e integruar "Master i Shkencave në Drejtësi"                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                          | Fakulteti i Drejtësisë                  | 100%                              | 2024-2025 |                                           |
|   |                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                             |      | U përmbush objektivi sipas planit të riutjes së cilësisë së kërkimit shkencor, pasi stafi është pjesë e 2 projekteve shkencore (AKKSHI dhe READ), si dhe e projektit F.R.I.D.A.S. që synim final kanë përkëmbjen e cilësisë së kërkimit shkencor. | 2024-2025 |  |
| 3 | Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor                                                                                                  | Aplikimi në projekte të financuara nga BE apo në të cilat Unishk ka aplikuar për financim.                                                                                                  | FSHE |                                                                                                                                                                                                                                                   |           |  |
|   | Rritja e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fushën e mësimdhënies dhe në fushën e aftësisë së kufizuar.                               | Kontakt i vazhdueshëm me literaturën shkencore bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, takime me kolegë të universiteteve partnere, pjesëmarrje në konferenca dhe tryeza të rumbullakëta. | FSHE | 100%                                                                                                                                                                                                                                              | 2024-2025 |  |
|   | Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor. Jo vetëm përmes aktiviteteve të ndryshme shkencore. por edhe punimeve individuale të tyre |                                                                                                                                                                                             | FSHE | 75%                                                                                                                                                                                                                                               | 2024-2025 |  |
| 5 | drejtuar nga pedagogët.                                                                                                                 | Përgatitje e studentëve me aftësi në kërkimin shkencor.                                                                                                                                     | FSHE |                                                                                                                                                                                                                                                   |           |  |
| 6 | Përditësimi me metoda të reja kërkimore.                                                                                                | Kontakt i vazhdueshëm me literaturën shkencore bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare.                                                                                                    | FSHE | 100%                                                                                                                                                                                                                                              | 2024-2025 |  |



Bazuar në këtë strategji, objektivat specifike të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” janë si më poshtë:

|                                          |  |
|------------------------------------------|--|
| 1. Rritja e cilësisë                     |  |
| 2. Përsosmeria në mësimdhënie dhe kërkim |  |
| 3. Ndërlidhja me tregun e punës          |  |
| 4. Integriteti dhe transparencë          |  |
| 5. Studentët                             |  |
| 6. Ndërkombëtarizimi i USH-se            |  |
| 7. Shërbimet digjitale                   |  |

#### Objektivi I: Rritja e cilësisë për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

- **Përfshirja në Mobilitete:** Plani i Universitetit synon përfshirjen e stafit akademik në mobilitete jashtë vendit, duke mos u kufizuar vetëm te projektet Erasmus Capacity Building, por edhe te programe të tjera si COST Actions dhe Eastern Balkans Fund. Realizimi i këtij plani arriti në 100% gjatë vitit akademik 2024-2025.
- **Vlerësimi i Performancës (360 Gradë):** Është miratuar Manuali i Vlerësimit të Performancës, i cili përcakton qëllimin, objektivat, parimet e përgjithshme dhe subjektet vlerësuese, duke përfshirë stafin akademik, grupet e interesit, studentët dhe strukturat drejtuese.

#### Objektivi II: Përsosmëria në mësimdhënie dhe kërkim

- **Programet Trajnuese:** Universiteti ka ofruar programe trajnuese për ngritje kapacitetesh të brendshme, të specializuara sipas profileve të fakulteteve. Këto trajnime janë realizuar në kuadër të projekteve ku USH është përfshirë, leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, dhe trajnimeve të administruara nga Zyra e Ekselencës (ZE).
- **Realizimi:** Janë realizuar **5 trajnime nga Zyra e Ekselencës**, me një pjesëmarrje totale prej **125 pedagogë**, 17 studentë, 8 anëtarë të administratës, si dhe 2 të jashtëm. Këto trajnime adresojnë përmirësimin e kapaciteteve të stafit në metodat e kërkimit shkencor dhe në publikimin e artikujve cilësor.

- **Financimi i Titujve Akademikë:** Universiteti ka financuar botime dhe pjesëmarrje në konferenca për gjithë stafin akademik dhe vecanërisht stafin në prag të marrjes së titujve akademikë. Si rezultat, gjatë këtij viti akademik janë fituar **3 tituj “Profesor i Asociuar” dhe 3 grada “Doktor”**.
- **Financimi i Artikuj/Konferenca:** **58, 2% e fondit të kërkimit shkencor të caktuar në buxhet** është shpenzuar për **rimbursimin e tarifave (fee-ve)** të pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe botimit të artikujve shkencorë.

### **Objektivi III: Rritja e përfshirjes së studentëve të programeve të ciklit të dytë dhe të tretë në kërkim shkencor.**

- **Angazhimi i Studentëve:** Ky objektivi synon angazhimin e studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë në projekte me qëllim hulumtime dhe kërkime në bibliotekë, online dhe në terren. Format e angazhimit përfshijnë ekspedita kërkimore, si dhe veprimtari krijuese/artistike e ekspozita. Përfshirja e studentëve është më e evidente në programet e ciklit të tretë në botime artikujsh me bashkëautorësi në mes pedagogëve udhëheës dhe doktorantëve, përfshirja aktive në konferencat shkencore të realizuara nga UNISHK dhe nga fakultetet, organizimi i konferencave studentore etj. .

**Fakulteti i Shkencave Shoqërore** ka orientuar realizimin e objektivave të tij drejt rritjes së cilësisë akademike, duke theksuar lidhjen organike midis kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Përmirësimi i kapaciteteve kërkimore mbetet një prioritet i qartë dhe po synohet forcimi gradual i traditës së punës në projekte kërkimore më të strukturuar dhe me ndikim më të gjerë. Prodhimtaria shkencore e stafit është e konsiderueshme, duke përfshirë monografi, tekste universitare, artikuj të botuar në revista kombëtare ndërkombëtare. Stafi i FSHSH-së është gjithashtu aktiv në rrjete ndërkombëtare kërkimore, si COST Action, duke zgjeruar ekspozimin dhe bashkëpunimet akademike në nivel europian. Në drejtim të kualifikimit të mëtejshëm, gjatë vitit akademik një kandidat ka përfunduar me sukses mbrojtjen e doktoraturës. Fakulteti ka zbatuar gjithashtu projekte kombëtare të financuara nga AKKSHI, si “Horizontet digjitale të transhumancës” dhe “Shtypi në Shkodër”, të cilat kontribuojnë në diversifikimin e tematikave dhe thellimin e kërkimit aplikativ.

Përfshirja e studentëve në kërkim shkencor mbetet një komponent thelbësor i misionit akademik të fakultetit. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në projekte kërkimore dhe të shfrytëzojnë mundësitë për botime shkencore, duke ndërtuar eksperiencë dhe kompetenca kërkimore që në fazat e hershme të formimit të tyre akademik. Aktivitetet e klubeve studentore “Arshi Pipa” dhe “Ernest Koliqi” shërbejnë si hapësira të rëndësishme për zhvillim profesional dhe kreativ. Një moment i veçantë ka qenë organizimi i Konferencës Studentore të Gjeografisë, ku studentët paraqitën kumtesa shkencore. Ndërkohë, doktorantët kanë dëshmuar angazhim aktiv, duke realizuar publikime dhe duke marrë pjesë në Konferencën Ndëruniversitare “Arbëreshi shkodran Leonardo De Martino”, duke reflektuar rritjen e kulturës së kërkimit në nivelet e avancuara të studimeve.

**Fakultetit i Shkencave të Natyrës** bazohet në tre shtylla kryesore—zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ndërkombëtarizimin—duke e vendosur në qendër forcimin e infrastrukturës laboratorike si kusht themelor për avancimin shkencor. Në kuadrin e rritjes së kapaciteteve kërkimore dhe inovacionit fakulteti synon një botime cilësore dhe me standarte të larta.

Infrastruktura laboratorike mbetet prioriteti kryesor i zhvillimit. Prej vitit 2022 janë në zbatim projektet e AKKSHI-t për modernizimin e Laboratorit Klinik–Biokimik dhe Laboratorit të Analizave të Ushqimeve, të cilat synojnë rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe ofrimin e shërbimeve të specializuara. Departamenti i Fizikës ka fituar projektin për ngritjen e Laboratorit Dozimetric, një arritje e rëndësishme që e pozicionon fakultetin në një nivel të ri të kërkimit të aplikuar. Ndërkohë, Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Eolfdieter Sixl” vijon të luajë një rol qendror si në kërkimin shkencor, ashtu edhe në shërbimet për palët e treta.

Përfshirja e studentëve në kërkim shkencor është intensifikuar përmes punimeve të diplomës në nivel Bachelor dhe në Master Shkencor—si dhe përmes projekteve që nxisin aftësitë digjitale dhe eksperimentale. Projekti BIOSINT ka mundur trajnimin dhe certifikimin e 21 studentëve në kompetenca digjitale të avancuara. Gjithashtu, dimensionin praktik i formimit profesional është forcuar përmes mobiliteteve, ku 13 studentë të Infermierisë kryen praktikën e tyre profesionale në Medjugorje (Bosnje), duke i ekspozuar ndaj standardeve ndërkombëtare të praktikës klinike.

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit** e orienton strategjinë e tij drejt integritetit të mësimdhënies me kërkimin shkencor, duke përcaktuar qarte prioritete kërkimore që lidhen ngushtësisht me realitetin lokal dhe rajonal. Ky orientim synon jo vetëm rritjen e cilësisë së arsimit, por edhe krijimin e njohurive të reja të zbatueshme në praktikën pedagogjike, psikologjike dhe sociale.

Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve kërkimore dhe përfshirjes në projekte, Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale ka shënuar arritje të dukshme me botimin e artikujve në revista ndërkombëtare të indeksuara (Scopus/Faktor Impakti). Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është botimi i librit universitar “Psikologji Shëndeti”, që forcon bazën didaktike dhe kërkimore të fakultetit. FSHE është gjithashtu pjesë aktive e projekteve ndërkombëtare, duke përfshirë CRED4TEACH, që synon zhvillimin e mikrokredencialeve për mësuesit, dhe F.R.I.D.A.S., i cili kontribuon në hartimin e kornizave të të drejtave të njeriut në praktikën e punës sociale. Pjesëmarrja në konferenca mbetet e lartë: vetëm Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale (DPPS) ka realizuar 24 prezantime shkencore, prej të cilave 18 ndërkombëtare, duke reflektuar një angazhim të theksuar në shkëmbimin akademik ndërkombëtar.

Në drejtim të trajnimit dhe inovacionit, stafi ka marrë pjesë në 8 trajnime dhe workshop-e profesionale, që kanë përfshirë metodologji bashkëkohore kërkimore si VOSViewer dhe NVivo, si dhe trajnimet mbi përdorimin pedagogjik dhe kërkimor të Inteligjencës Artificiale. Këto aktivitete kanë ndihmuar në rritjen e kapaciteteve metodologjike dhe përdorimin e mjeteve të avancuara në analizën e të dhënave.

Përfshirja e studentëve në kërkim është një shtyllë themelore e misionit të fakultetit. Studentët inkurajohen të zhvillojnë mini-kërkime shkencore dhe të marrin pjesë në proceset e mbledhjes dhe interpretimit të të dhënave. Në Departamentin e Arteve, veprimtaria krijuese është veçanërisht e zhvilluar: ekspozita vjetore “Expo 25”, si dhe ekspozitat tematike si “Psiko-ekspozitë”, dëshmojnë lidhjen e ngushtë ndërmjet krijimtarisë artistike dhe kërkimit, duke shërbyer si hapësira të rëndësishme zhvillimi për studentët dhe komunitetin akademik të fakultetit.

**Fakulteti i Drejtësisë** e zhvillon veprimtarinë e tij kërkimore në harmoni me Strategjinë e Universitetit të Shkodrës, duke synuar avancimin shkencor në koncept, teknologji dhe metodologji juridike. Qasja e tij fokusohet në ndërtimin e kapaciteteve akademike, përfshirjen në projekte me ndikim praktik dhe rritjen e rolit të kërkimit në proceset e reformës ligjore dhe integritetit evropian.

Në drejtim të kapaciteteve dhe projekteve, fakulteti ka shënuar arritje të dukshme në kualifikimin akademik të stafit, me përfundimin me sukses të dy gradave “Doktor i shkencave” dhe përfitimin e titullit “Profesor i asociuar” nga një prej pedagogëve. Prodhimtaria shkencore e FD-së përfshin artikuj të botuar, disa prej të cilëve të indeksuar në Scopus, duke reflektuar përmirësimin e cilësisë dhe impaktit akademik. Fakulteti ka organizuar gjithashtu Konferencën Shkencore Ndërkombëtare CONFLAW24, në bashkëpunim me Universitetin e Firences, një aktivitet i rëndësishëm shkencor me fokus në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Paralele me këtë, projektet e fakultetit trajtojnë problematika me ndikim të drejtpërdrejtë në shoqëri, si projekti mbi përmirësimin e zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike falas, duke kontribuar në forcimin e aksesit në drejtësi.

Në fushën e trajnimit, stafi akademik ka marrë pjesë në trajnime dhe workshop-e ndërkombëtare që trajtojnë çështje kyçe të së drejtës së BE-së, të drejtave themelore dhe luftës kundër diskriminimit. Trajnime të tilla, si ato të zhvilluara nga Academy of European Law (ERA) në Madrid dhe Trier, kanë ndihmuar në përditësimin e njohurive juridike dhe në rritjen e kompetencave profesionale të stafit.

Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor është një nga pikat më të forta të fakultetit. Përmes Klinikës së Ligjit, studentët punojnë në raste konkrete që lidhen me zbatimin e legjislacionit për ndihmën juridike falas, duke përvetësuar aftësi praktike dhe metodike të kërkimit juridik. Konferenca Studentore “Dita e Drejtësisë” u ofron atyre një platformë të rëndësishme për prezantimin e punimeve shkencore. Gjithashtu, studentët kanë përfaqësuar fakultetin në gjyqe imituese ndërkombëtare, si Telders International Law Moot Court Competition në Hagë, duke fituar përvojë të vlefshme në argumentimin juridik dhe procedurat ndërkombëtare të drejtësisë.

**Fakulteti Ekonomik** e ka orientuar strategjinë e tij drejt forcimit të kërkimit shkencor dhe nxitjes së inovacionit, me synimin për t’u pozicionuar si një pikë referimi kërkimore në nivel rajonal. Ky orientim mbështetet në prodhimin shkencor të fokusuar te zgjidhja e problemeve konkrete ekonomike në rajon dhe krijimi i një kulture kërkimore të lidhur ngushtë me zhvillimet e tregut dhe nevojat e komunitetit.

Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve dhe përfshirjes në projekte, stafi akademik inkurajohet të publikojë në revista të indeksuara me impakt shkencor, duke synuar rritjen e cilësisë dhe dukshmërisë ndërkombëtare të prodhimit të kërkimor. Gjatë vitit akademik, tre pedagoge kanë dorëzuar dosjet për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar”, çka dëshmon rritjen e kapacitetit akademik dhe profesional të fakultetit. Një element kyç ka qenë organizimi i Seminarit të Metodologjisë Kërkimore (10-javor), i realizuar me ekspertë të diasporës në kuadër të READ/AADF, i cili kontribuoi ndjeshëm në rritjen e kompetencave kërkimore të stafit dhe doktorantëve. Fakulteti ka qenë shumë aktiv në projekte të rëndësishme, duke përfshirë projektin SMART, që synon ngritjen e qendrave të inovacionit, si dhe projektin e AKKSHI-t për ngritjen e laboratorit Fab Lab, me fokus në ekonominë qarkulluese dhe teknologjitë digjitale. Këto iniciativa synojnë të forcojnë rolin e SMART Business Hub si nyje inovacioni dhe sipërmarrjeje në nivel rajonal. Aktiviteti shkencor i stafit vërtetohet edhe nga pjesëmarrja në mbi 70 konferenca ndërkombëtare, duke rritur ekspozimin akademik dhe mundësitë për bashkëpunime kërkimore.

Përfshirja e studentëve dhe inovacioni zënë një vend të veçantë në vizionin zhvillimor të fakultetit. Studentët e programeve Master janë përfshirë maksimalisht në punime analitike, kërkime aplikative dhe diskutime të rasteve reale, duke integruar teorinë me praktikën dhe duke u përballur me sfidat reale të ekonomisë bashkëkohore. Veçanërisht e spikatur ka qenë pjesëmarrja e tyre në fushën e inovacionit: një ekip studentor i Fakultetit Ekonomik u rendit fitues në konkursin kombëtar “SMART Idea Pitching Event – Albania” me idenë inovative “Glucoplast”, e cila jo vetëm u kualifikua për finalen rajonale, por fitoi edhe çmimin kryesor. Ky sukses pasqyron qartë potencialin krijues dhe aplikativ të studentëve, si dhe rolin e fakultetit në mbështetjen e sipërmarrjes së re dhe inovacionit rajonal.

**Fakulteti i Gjuhëve të Huaja** synon përmirësimin cilësor të punës kërkimore duke zbatuar metodologji bashkëkohore dhe duke forcuar ndërkombëtarizimin, me fokus të veçantë në gjuhësi, letërsi dhe komunikim ndërkulturor. Qasja e tij strategjike ndërthur zhvillimin akademik me përdorimin e teknologjisë dhe me angazhimin e studentëve në aktivitete kërkimore dhe kulturore që pasurojnë përvojën e tyre formuese.

Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve dhe projekteve, fakulteti ka arritur të realizojë botime në revista shkencore, disa prej të cilave janë të indeksuara, duke dëshmuar rritjen e nivelit të prodhimit të akademike. FGJH ka zbatuar gjithashtu projekte me ndikim konkret dhe të drejtpërdrejtë në komunitet, si PLACOD, i cili solli krijimin e një platforme digjitale për promovimin e Shkodrës në gjuhë të huaja. Departamenti i Gjuhës Angleze ka realizuar me sukses projektin “VideoChallenge në Anglisht: Edukimi për Median dhe Informacionin”, të mbështetur nga Ambasada Amerikane, duke integruar edukimin mediatik me zhvillimin e kompetencave gjuhësore.

Në drejtim të trajnimit të stafit, fakulteti ka qenë i fokusuar në përdorimin e teknologjisë dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Departamenti i Gjermanistikës ka zhvilluar webinar-e dhe sesione trajnimi mbi përdorimin e Inteligjencës Artificiale në hartimin e provimeve dhe

materialeve didaktike, duke kontribuar në modernizimin e praktikave pedagogjike dhe në rritjen e kompetencave digjitale të stafit akademik.

Përfshirja e studentëve në kërkim dhe aktivitetet akademike është një komponent kyç i zhvillimit të fakultetit. Studentët janë inkurajuar të realizojnë punime individuale dhe në grup, si dhe të marrin pjesë në aktivitete kërkimore në terren. Një shembull i spikatur është aktiviteti “Eksplorim gjuhësor në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut”, i cili synoi dokumentimin e përdorimit të gjuhës angleze në hapësira të ndryshme gjeografike. Në të njëjtën linjë, aktivitetet kulturore si “Cineforum” dhe “Trivia Quizz” krijuan hapësira për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore dhe zbatimin praktik të njohurive teorike.

Mobiliteti Erasmus+ ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e përvojës studentore, duke u mundësuar studentëve pjesëmarrjen në universitete partnere si Vechta (Gjermani) dhe Messina (Itali), duke forcuar kështu aftësitë gjuhësore, akademike dhe kulturore të tyre.

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstytucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, të dhëna mbi institucionet bashkëpunuese apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit, detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

Bashkëpunimi ndërinstytucional është një nga shtyllat kryesore të strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për periudhën 2022-2026. Ky bashkëpunim synon forcimin e kapaciteteve akademike dhe kërkimore, ndërkombëtarizimin e procesit të mësimdhënies dhe rritjen e përfshirjes së studentëve në aktivitete kërkimore e profesionale. Bashkëpunimet janë realizuar me institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim mësimdhënien si dhe kërkimin shkencor. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (USH) ka forcuar ndjeshëm bashkëpunimet ndërinstytucionale dhe angazhimin në projekte kërkimore-shkencore, duke synuar ndërkombëtarizimin, zhvillimin e kapaciteteve digjitale dhe përmirësimin e infrastrukturës. Gjatë vitit akademik 2024–2025, Sektori i Ndërkombëtarizimit ka finalizuar **12 marrëveshje të reja bashkëpunimi dypalësh** me universitete dhe organizata të huaja dhe **18 marrëveshje me ente publike dhe universitete shqiptare**, duke përfshirë partneritete me institucione si Universiteti i Sienës, Universiteti Ndërkombëtar i Studimeve të Romës, GIZ, Kryqi i Kuq Shqiptar etj. Në nivel instytucional, USH ka vijuar zbatimin e disa projekteve të mëdha, kryesisht të Programit Erasmus+ Capacity Building (CB), me fokus në reformën kurrikulare dhe digjitalizimin, si dhe projekte të kërkimit shkencor në fushën e mjedisit dhe shkenca sociale.



| <b>Nr</b> | <b>Titulli i projektit</b>                                                                                                                                                    |
|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1         | Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans - Project number: 101128620<br>TCCWB                                   |
| 2         | University to society collaborations for inclusive digital transformation in the Western Balkans, Project Number 101083131 U2SID                                              |
| 3         | Strengthening capacities and digital competences in biomedical education through internationalization at home – BIOSINT - Project number: 101082863                           |
| 4         | “Fundamental Rights in Daily Actions of Social Workers (Fridas)” Project Number: 2024-1-IT02-KA220-HED-000251953                                                              |
| 5         | SMART/ Innovation Centres for the Development of Innovative and Entrepreneurial Thinking to Facilitate the Development of Sustainable Smart Solutions in the Western Balkans” |
| 6         | ESN-AIR / Engaging Students for eNhancing internationalization practices in the Adriatic-Ionian Region                                                                        |
| 7         | MOOC-based micro-credentials for teacher professional development- CRED4TEACH<br>Projekti Nr.: 101082858                                                                      |
| 8         | E-Learning Gamified and Networked Training for Startupper Project 101082811                                                                                                   |
| 9         | Sport, Health, and the People - A Western Balkan University Network                                                                                                           |
| 10        | Accreditation of Prior Experiential Learning Capacity-Building in the Western Balkans: APEL-WB<br>(Project 101236402)                                                         |
| 11        | SPEEDY, Interreg IPA South Adriatic – SA, No. SA-0300297                                                                                                                      |
| 12        | ADRISMART, IPA – SA, No. SA-0300386                                                                                                                                           |
| 13        | READ - Migration, life satisfaction, and the tolerance of corruption and autocracy. AADF                                                                                      |
| 14        | READ - Promoting Awareness of Intercultural Communication for Pre-Service Teachers in Northern Albania. AADF                                                                  |
| 15        | AKKSHI - Standardizimi i mjeteve të vlerësimit psikologjik                                                                                                                    |

**Fakulteti i Shkencave Shoqërore** e ka orientuar bashkëpunimin e tij kërkimor drejt projekteve kombëtare dhe rrjeteve evropiane, duke i ndërthurur këto me partneritete të qëndrueshme me institucionet kulturore vendore. Kjo qasje e pozicionon FSHSH-në si një aktor aktiv në studimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, në analizën e proceseve shoqërore bashkëkohore dhe në zhvillimin e metodave të punës kërkimore në terren.

Një nga projektet më përfaqësuese në këtë drejtim është **“Horizontet Digjitale të Transhumancës (jetës baritore)”**, një projekt kombëtar i financuar nga AKKSHI dhe aktualisht në zbatim. FSHSH, përmes Departamentit të Letërsisë dhe të Gjeografisë është partner i vetëm në këtë nismë, e cila synon ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë etnokulturore të Alpeve shqiptare. Projekti prodhon materiale dokumentuese me vlerë të lartë shkencore—si leksikon tradicional dhe elementë të kulturës baritore—duke kontribuar kështu në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm në zonat malore dhe në pasurimin e studimeve humanistike.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, fakulteti është aktiv në grupet **COST Actions**, rrjete kërkimor evropian që synojnë forcimin e bashkëpunimit shkencor dhe inovacionit.

Në fushën e kërkimit social, FSHSH është i përfshirë në projektin e mbështetur nga AADF në kuadër të programit READ: **“Migration, life satisfaction, and the tolerance of corruption and autocracy...”**, i cili ka nisur në Qershor 2025 dhe vijon ende. Projekti analizon marrëdhënien ndërmjet migracionit, kënaqësisë me jetën dhe tolerancës ndaj korrupsionit në shoqëritë tranzitore, duke kontribuar në literaturën bashkëkohore mbi mekanizmat shoqërorë të transformimit post-komunist.

Një element i rëndësishëm i profilit të fakultetit mbetet bashkëpunimi me institucionet kulturore lokale, si Muzeu Historik i Shkodrës, Muzeu i Fotografisë “Marubi”, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore – Shkodër dhe Biblioteka “Marin Barleti”. Këto partneritete shërbejnë si platforma të vlefshme për zhvillimin e praktikave mësimore në terren, duke u ofruar studentëve mundësinë të ndërthurin teorinë me kërkimin praktik, të hyjnë në arkiva, të analizojnë materiale autentike dhe të zhvillojnë kompetenca të mirëfillta kërkimore.

Në tërësi, FSHSH ndërton një profil kërkimor të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt realitetit social e kulturor, përmes një kombinimi të projekteve shkencore, partneriteteve kombëtare e ndërkombëtare dhe bashkëpunimit të ngushtë me institucionet kulturore të qytetit.

**Fakulteti i Shkencave Natyrore** Një prej iniciativave më të rëndësishme ka qenë projekti i financuar nga AKKSHI për Ngritjen e Laboratorit Dozimetric Sekondar, i cili u lançua në janar 2025 dhe synon të krijojë një laborator modern për monitorimin e ekspozimit ndaj rrezatimit jonizues tek stafet mjekësore të rajonit të veriut. Ky projekt përfaqëson një hap thelbësor drejt

rritjes së kapaciteteve kërkimore në fushën e sigurisë radiologjike dhe konsolidimit të infrastrukturës së fizikës mjekësore në fakultet.

Në fushën e ekologjisë dhe menaxhimit të ujërave, FSHN ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për projektin **“Monitorimi i integruar i ndotësve dhe vlerësimi i përditësuar i ujërave të Liqenit të Shkodrës”**, i cili synon të gjenerojë evidenca shkencore dhe rekomandime për menaxhim të qëndrueshëm të liqenit. Projekti forcon rolin e departamenteve përgjegjëse si aktorë kritikë në studimin e ekosistemeve natyrore.

Një tjetër drejtim prioritar është biodiversiteti dhe menaxhimi i habitateve. Fakulteti është partner në projektin ndërkombëtar Interreg IPA South Adriatic – **SPEEDY**, i cili ka si objektiv ruajtjen e biodiversitetit detar dhe menaxhimin efektiv të specieve dhe habitateve të ndjeshme në rajonin Adriatik–Jon. Paralelisht, në bashkëpunim me organizatën CNVP — **Connecting Natural Values and People**, fakulteti kontribuon në iniciativat për ruajtjen e biodiversitetit lumor dhe menaxhimin e integruar të habitateve të ujërave të ëmbla.

Në fushën laboratorike, Departamenti i Biologji–Kimisë vijon zbatimin e dy projekteve afatgjata të financuara nga AKKSHI dhe Universiteti i Shkodrës: Laboratori Klinik–Biokimik dhe Laboratori i Analizave të Ushqimeve, të cilat po modernizojnë infrastrukturën e kërkimit dhe praktikës laboratorike, duke rritur kapacitetet shkencore dhe pedagogjike të fakultetit.

FSHN ka zhvilluar bashkëpunime të gjera me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, duke e lidhur kërkimin shkencor me nevojat e tregut të punës dhe me sfidat shëndetësore të komunitetit. Një partneritet afatgjatë me Organizatën Malteser Albania ka përfshirë aktivitete ndërgjegjësuere dhe praktikë profesionale për studentët, të cilët janë angazhuar në evente edukuese dhe një program njëjavor praktik në Medjugorje, Bosnje. Fakulteti ka bashkëpunuar gjithashtu me Odan e Infermierëve të Kosovës, duke marrë pjesë si partner në Kongresin Ndërkombëtar të Profesionistëve të Kujdesit Shëndetësor, si dhe me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, që siguron baza reale për praktikat klinike të studentëve.

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit** Fakulteti i Shkencave të Edukimit (FSHE) ka konsoliduar gjatë vitit akademik 2024–2025 një rrjet të qëndrueshëm partneritetesh dhe projektesh, të cilat e pozicionojnë atë si një njësi kyçe të Universitetit të Shkodrës në fushat e arsimit gjithëpërfshirës, psikologjisë, punës sociale dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Bashkëpunimet ndërkombëtare dhe projektet kërkimore kanë krijuar një infrastrukturë të re akademike dhe profesionale, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e programeve të studimit dhe në fuqizimin e studentëve.

Një nga nismat më të rëndësishme të fakultetit është projekti kërkimor F.R.I.D.A.S (“Fundamental Rights in Daily Actions of Social Workers”), i formalizuar përmes marrëveshjes së bashkëpunimit të datës 28.10.2024. Ky projekt angazhon Departamentin e Psikologjisë dhe Punës Sociale në një konsorcium evropian me universitete të mirënjohura si Universiteti Roma TRE, NTNU Norvegji, Universidad de Granada dhe organizatën REDU në Itali. Projekti synon të hartojë një kornizë kompetencash në fushën e të drejtave të njeriut për punonjësit socialë të së ardhmes, duke krijuar

standarde të reja teorike dhe praktike. Përfituesit kryesorë janë studentët e Punës Sociale, të cilët marrin akses në burime të specializuara, përfshirë qasje ndërkulturore, etikë profesionale dhe dimensionin e të drejtave të njeriut në praktikën shoqërore. Një investim i rëndësishëm në infrastrukturë është Laboratori Gjithëpërfshirës, produkt i projektit të Erasmus+ IDEA – “**Arsimi i Lartë Gjithëpërfshirës në Ballkanin Perëndimor**”. Ky laborator, i vendosur në godinën e Bibliotekës së USH-së, ofron pajisje teknologjike bashkëkohore për studentët me vështirësi në të nxënë dhe aftësi të kufizuara. Laboratori përdoret gjerësisht nga programi Master Profesional në “Pedagogji Speciale” dhe shërben si model praktik për integrimin e arsimit gjithëpërfshirës në nivel universitar. Në vijim të forcimit të ndërkombëtarizimit, FSHE ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me UNINT – Universitetin Ndërkombëtar të Romës (10.07.2025). Kjo marrëveshje mbështet shkëmbimet e studentëve dhe stafit në fushat e Psikologjisë së të Nxënit, Psikologjisë Organizative dhe proceseve gjithëpërfshirëse. Ajo garanton mobilitete pa tarifa, njohje reciproke të krediteve dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e kurrikulave dhe metodologjive të vlerësimit.

**Fakulteti i Drejtësisë (FD)** ka konsoliduar bashkëpunimet institucionale dhe projektet kërkimore në funksion të forcimit të kulturës juridike dhe mbështetjes së procesit të integritetit evropian. Një nga bashkëpunimet më të rëndësishme të vitit ka qenë ai me Universitetin e Firences, i cili u konkretizua me organizimin e konferencës shkencore ndërkombëtare CONFLAW24. Kjo ngjarje akademike ka shërbyer si platformë për debat shkencor mbi përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, duke afirmuar rolin e FD-së si aktor i rëndësishëm në diskutimet juridike rajonale.

Në nivel projektesh aplikative, FD ka zbatuar iniciativën “**Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike falas**”, e realizuar nga Departamenti i të Drejtës Publike dhe Klinika e Ligjit. Projekti ka forcuar dimensionin praktik të formimit juridik, duke angazhuar pedagogë dhe studentë në çështje konkrete të së drejtës së aksesit në drejtësi dhe duke rritur bashkëpunimin me institucionet vendore. Ky bashkëpunim institucional është zgjeruar më tej me nënshkrimin e marrëveshjes me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, e cila ka kontribuar në organizimin e aktiviteteve akademike, kërkimore dhe të praktikës profesionale.

FD ka vijuar gjithashtu të ndërkombëtarizojë kapacitetet e tij akademike përmes mobilitetit Erasmus+, ku pesë pedagogë kanë zhvilluar mësimdhënie në Universitetin e Mesinës dhe Universitetin e Bergamos, duke forcuar shkëmbimet akademike dhe integrimin e praktikave bashkëkohore të mësimdhënies. Ky rrjetëzim institucional, së bashku me projektet kërkimore dhe bashkëpunimet vendore, e pozicionon Fakultetin e Drejtësisë si një qendër dinamike të prodhimit shkencor juridik dhe edukimit profesional. Një nga arritjet kryesore të këtij fakulteti është marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin e Selanikut në bazë të së cilës po punohet për programe të përbashkëta studimi në fushën e drejtësisë.

**Fakulteti Ekonomik (FE)** ka ndërtuar gjatë vitit akademik 2024–2025 një portofol të fuqishëm projektesh dhe bashkëpunimesh institucionale, të cilat e pozicionojnë atë si një aktor të

rëndësishëm në inovacion, digjitalizim dhe zhvillimin e ekonomisë qarkulluese. Nëpërmjet projekteve të financuara, partneriteteve me ekspertë të diasporës dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, fakulteti ka arritur të krijojë një ekosistem që lidh kërkimin shkencor me sipërmarrjen, teknologjinë dhe zhvillimin rajonal. Një ndër projektet më të rëndësishme në zbatim është **“Fab-Lab i Universitetit për Ekonominë Qarkulluese”**, një projekt i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) i financuar nga AKKSHI (Janar 2025). Ky projekt synon ngritjen e një laborator digjital (Fab Lab) brenda FE-së, i cili do të përdorë teknologji të avancuara dhe materiale të ricikluara për zhvillimin e produkteve inovative. Qëllimi afatgjatë është ta shndërrojë laboratorin në një qendër rajonale kërkimi dhe inovacioni në fushën e ekonomisë qarkulluese.

FE është gjithashtu partner në projektin **SMART** (Erasmus+ CBHE), i cili mbështet ngritjen dhe konsolidimin e SMART Business Hub, një qendër inovacioni që synon krijimin e një ekosistemi sipërmarrjeje të qëndrueshme për rajonin e Shkodrës dhe më gjerë. Projekti përfshin ndërthurjen e teknologjisë me zhvillimin e modeleve të reja biznesi, hartimin e trajnimeve profesionale dhe organizimin e aktiviteteve që nxisin krijimtarinë dhe sipërmarrjen e studentëve, si **“SMART Idea Pitching Event – Albania”**. Një nga bashkëpunimet akademike më të rëndësishme është projekti **READ (AADF)**, në kuadër të të cilit FE organizoi një Seminar 10-javor të Metodologjisë Kërkimore (Shtator–Nëntor 2024). Ekspertja e diasporës, Prof. Ritvana Rukaj, zhvilloi leksione online për stafin dhe doktorantët e Turizmit, duke mbështetur zhvillimin metodologjik të doktoraturës në **“Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm”**. Ky bashkëpunim ka rritur cilësinë e kërkimeve dhe të publikuarave shkencore të departamentit. Në vijim të modernizimit të kurrikulave, FE ka forcuar bashkëpunimet me kompani ndërkombëtare të teknologjisë. Në bashkëpunim me IBM, fakulteti organizoi trajnimin kombëtar **“Data Analyst në Cloud”** (30.04.2025), duke i mundësuar studentëve të kontabilitetit dhe financës akses në praktika bashkëkohore të analizës së të dhënave dhe teknologjive cloud.

FE është përfshirë gjithashtu në projekte të tjera me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimet digjitale dhe sipërmarrjen e të rinjve, si:

- AKKSHI – “Fuqizimi i të Ardhmes: Aftësitë Digjitale dhe Sipërmarrja e të Rinjve”,
- Diaspora4Innovation, mbështetur nga GIZ dhe GERMIN,
- AKKSHI – Fab Lab, si projekt shtesë për infrastrukturë digjitale,
- READ, AADF - “Migration, life satisfaction, and the tolerance of corruption and autocracy
- APEL-WB, për akreditimin e të mësuarit përvojësor në arsimin e lartë.

FE ka zgjeruar rrjetin e partnerëve përmes pjesëmarrjeve në rrjetet COST Action (CA20115, CA21107, CA21133), marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete si EDUCONS, përfshirjes së stafit dhe studentëve në mobilitete Erasmus+ në Poloni, Itali, Spanjë dhe Mal të Zi.

**Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FGJH)** ka vijuar të forcojë profilin e tij akademik përmes projekteve kërkimore, bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe nismave që lidhin gjuhësinë, edukimin

mediatik dhe zhvillimin kulturor rajonal. Ndër veprimtaritë më të rëndësishme spikatin projektet me ndikim konkret në komunitetin universitar dhe atë lokal.

Në kuadër të bashkëpunimit me Agjencinë Universitare të Frankofonisë (AUF), FGJH ka përfunduar projektin **PLACOD**, i cili synoi krijimin e një platforme digjitale për promovimin e Shkodrës dhe territorit përreth. Përmes një faqeje web të dedikuar, janë përgatitur dhe përkthyer itinerare të udhëtarëve të huaj në të gjitha gjuhët e ofruara nga fakulteti, duke i dhënë qytetit një mjet të ri prezantimi ndërkulturor dhe turistikor.

Një tjetër projekt me impakt të gjerë ishte **“VideoChallenge në Anglisht: Edukimi për Median dhe Informacionin”**, i realizuar me mbështetjen e Ambasadës Amerikane. Ai synoi integrimin e kompetencave të edukimit mediatik në mësimdhënien e gjuhës angleze, duke i angazhuar studentët e Masterit dhe nxënësit e shkollave të mesme në prodhimin e 22 videove edukative në anglisht. Këto materiale u prezantuan në një event final dhe u publikuan në kanalin **“Media Literacy UNISHK”**, duke zgjeruar ndikimin e projektit përtej auditorëve universitarë.

Me mbështetjen e Fondacionit AADF, fakulteti fitoi projektin **READ**, i cili synon trajnimin e studentëve të ciklit të dytë dhe mësuesve të rinj në fushën e komunikimit ndërkulturor, menaxhimit të konflikteve dhe kompetencave sociale, një kontribut i drejtpërdrejtë në formimin profesional të mësuesve të ardhshëm.

Një shtyllë e rëndësishme mbetet anëtarësimi i Departamentit të Gjermanistikës në rrjetin **Kultur und Sprache (KuS)** në Vjenë, i cili ka mundësuar zhvillimin e workshop-eve dhe webinar-eve me fokus metodologjitë bashkëkohore dhe integrimin e Inteligjencës Artificiale në mësimdhënie. Përmes këtij rrjeti, stafi ka akses në trajnime ndërkombëtare dhe studentët në aktivitete kulturore që nxisin ndërveprimin ndërkulturor. Bashkëpunimet ndërkombëtare i japin fakultetit një dimension të rëndësishëm zhvillimi. Përmes programit Erasmus+, studentët kanë kryer mobilitete në Universitetin e Vechta-s në Gjermani dhe Universitetin e Messinës në Itali, duke fituar përvoja akademike dhe kulturore të vlefshme. Përveç kësaj, fakulteti mirëpret edhe pedagogë të huaj, si lektorët austriakë të OeAD dhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane, të cilët kontribuojnë në pasurimin e mësimdhënies dhe jetës kulturore të departamenteve.

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAl ose mbi projektet ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin

Universiteti i Shkodrës **“Luigj Gurakuqi” (USH)** ka ndërtuar një portofol të gjerë projektesh kërkimore, inovative, ndërkufitare dhe institucionale, duke e pozicionuar veten si një aktor të rëndësishëm në modernizimin e arsimit të lartë dhe në përmbushjen e objektivave të ndërkombëtarizimit. Projektet shërbejnë si mekanizma kyç për rritjen e cilësisë akademike, përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, forcimin e lidhjes me komunitetin dhe sigurimin e burimeve financiare shtesë që mbështesin transformimin institucional.

### **Tabela nr. 3: Mbi bashkëpunimin institucional**



UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional

| FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE |                                                           |                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                |                                                                                     |                                                                                                       |                                                                                                                        |
|---------------------------------|-----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nr                              | Institucioni bashkëpunues                                 | Lloji i bashkëpunimit (projekti, bashkëpunim tjetër) | Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit (martëveshje ose të tjera)                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Data e nënshkrimit të martëveshjes                             | Fusha e bashkëpunimit                                                               | Dejtyrat e palëve dhe produktet (të përmëdhura)                                                       | Rezultate/Përfitimet (në Vlerë)                                                                                        |
| 1                               | Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar              | Bashkëpunim akademik dhe trajnues                    | Martëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional me Ascal                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 2024-2025                                                      | Trajnime profesionale për mësuesit e gjeografisë e historisë për keshillim karriere | Unishtë siguroi trajnuesit e Drejtoria rajonale siguroi pjesëmarrësit dhe mbështetjen institucionale. | Rritja e kapaciteteve profesionale të mësuesve dhe forcimi i lidhjes mes arsimit universitar dhe atij parauniversitar. |
| 2                               | Ministria e Arsimit dhe e Sportit                         | Projekti ne infrastrukture                           | Investim i përbashkët ne ambientet e FSHSH-se                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 25 korrik 2023, Nr.4398/I prot.                                | projekti i përbashkët ne kuader te ndërkombetarizimi                                | permblushtja e dejtymene sipas fazave te projektit.                                                   | venia ne funksion e laboratorit ne shërbim te studenteve (salla 504, god. FSHSH)                                       |
| 3                               | Universiteti i Salentos/Ministria e Arsimit dhe e Sportit | Diplome e dyfishte                                   | Martëveshje per programin e studimit Bachelor ne Trashëgimi Kulturere/MAS - Urdher Nr.300, dt.2.07.2025 PER RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIIMIT TË CIKLLIT TË PARË NGA BACHELOR NË "HISTORI DHE TRASHËGIMI KULTURORE" NË PROGRAM TË PËRBASHKËT STUDIIMI BACHELOR NË "TRASHËGIMI KULTURORE". NË UNIVERSITETIN "LUIGJ GURAKUQI". SHKODËR ME UNIVERSITETIN E SALENTOS, ITALI | 11 tetor 2023, Nr.3126 prov/MAS - Nr.4175/I Prot. dt.2.07.2025 | program studimi Bachelor ne Trashëgimi Kulturere                                    | Riorganizimi i Programit Bachelor ne "Trashëgimi kulturere".                                          | Programi i studimit (diplome e dyfishte)                                                                               |
| 4                               | Vendi i deshmise dhe kujteses                             | Projekti. Bashkëpunim me USH                         | Martëveshje me Drejtorine Rajonale te Trashëgimise Kulturere Shkoder                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | .....                                                          | projekti i përbashkët ne kuader te ndërkombetarizimi                                | permblushtja e dejtymene sipas fazave te projektit.                                                   | Botimi i rezultateve te kerkimit ne Buletinin Shkencor te FSHSH                                                        |



|   |                                                              |                                                        |            |                               |                                                        |                                                    |                                                                                    |
|---|--------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|------------|-------------------------------|--------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|
| 5 | Drejtona e kultures dhe Trashgimise Kulturore, Bashkia Lezhe | Projekti i perbashket ne kuader te ndertkombetarizimit | Marrveshje | Nr. 5143 Prot. dt. 29.04.2025 | projekti i perbashket ne kuader te ndertkombetarizimit | permbushja e detyrimeve sipas fazave te projektit. | bashkepunimi nderinstitucional, zhvillimin e aktiviteve informuese dhe te zbatuara |
|---|--------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|------------|-------------------------------|--------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|

| FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES |                                                |                                                      |                                                                                   |                                    |                       |                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------------------------|------------------------------------------------|------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|-----------------------|----------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 34 | Ardita Borici   | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit | Shkodra International Economic Conference "Smart Economy: Shaping the Future with AI" SHKODRA IEC2025.                                     |                                                                                                                    |
|    |                 |    |                                     |                                                                                                                                            |                                                                                                                    |
|    |                 |    |                                     |                                                                                                                                            | Project Management Committee, Projektit APEL-WB per UNISHK (Erasmus+, Capacity Building in Higher Education) 2025. |
| 35 | Ardita Borici   | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit |                                                                                                                                            |                                                                                                                    |
|    |                 |    |                                     |                                                                                                                                            |                                                                                                                    |
| 36 | Mario Curcija   | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit | Journal of Economic and Social Studies" INTERNATIONAL BURCH UNIVERSITY                                                                     | Projekti Erasmus+ "SUCCESS"                                                                                        |
|    |                 |    |                                     |                                                                                                                                            |                                                                                                                    |
| 37 | Brikene Dionizi | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit | U2SID - Erasmus + CBHE Project (mbaruar me 31.3.2025)                                                                                      |                                                                                                                    |

|    |                 |    |                                     |                                                                                                                                                                                  |  |
|----|-----------------|----|-------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| 38 | Albana Boriçi   | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit | Anëtare e Komisionit të Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore Doktor                                                                                                          |  |
| 39 | Albana Boriçi   | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit | International Conference "Challenges of Sustainable Tourism Development" CONFOUR 2025, Shkoder, Albania                                                                          |  |
| 40 | Albana Boriçi   | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit | Shkoder International Economic Conference "Smart Economy: Shaping the Future with AI" SHKODRA IEC2025, Shkoder, Shqipëri.                                                        |  |
| 41 | Albana Boriçi   | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit | Anëtare e redaksisë së Buletinit Shkencor të USH-së, Seria e Shkencave Ekonomike                                                                                                 |  |
| 42 | Albana Boriçi   | FE | Departamenti i Administrim-Biznesit | International Conference, AI-SMART, 25-25 Shtator 2025, Beograd, Serbi                                                                                                           |  |
| 43 | Bleta Dragusha  | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjese e bordit shkencor ne Konferencen shkencore te biznesit, II, "Leadership, Innovation, management and economics: Integrated politics of research - Limen 2025, Zyrih, Zvicer |  |
| 44 | Fatbardha Molla | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Kryeredaktore e buletinit te shkencave ekonomike                                                                                                                                 |  |
| 45 | Bleta Dragusha  | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjese e bordit te buletinit shkencor te serise se shkencave ekonomike ne USH                                                                                                     |  |
| 45 | Elidiana Bashi  | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjese e bordit te buletinit shkencor te serise se shkencave ekonomike ne USH                                                                                                     |  |
| 46 | Elidiana Bashi  | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Koordinator e projektit te financuar nga AKKSHI: Fab lab, per ekonomine qarkulluese                                                                                              |  |
| 46 | Bleta Dragusha  | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjese e projektit Diaspora4innovation - bashkepunim me Akademiken e diaspores Prof Valentina Ndou                                                                                |  |

|    |                    |    |                                     |                                                                                                                                                                                                               |  |
|----|--------------------|----|-------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| 47 | Erмира Kalaj       | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjesemarrse ne projektin e BE-se<br>Cost Action: Transdisciplinary network to bridge climate science and impacts on society                                                                                   |  |
| 48 | Erмира Kalaj       | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjesemarrse ne projektin e BE-se cost action: Eu circular economy network for all: consumer protection through reducing, reusing, repairing (ECO4ALL)                                                         |  |
| 49 | Erмира Kalaj       | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjesemarrse ne projektin e BE-se<br>Cost Action: Globalization, Illicit trade, sustainability and security                                                                                                    |  |
| 50 | Erjola Barbullushi | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjesemarrse ne projekti U2SID - university to society collaborations for inclusive digital transformation in the western balkans-erasmus plus capacity building project, koordinator e paketes se punes nr 5. |  |
| 51 | Elidiana Bashi     | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Kryetare e komisionit te dhenies se grades shkencore doktor                                                                                                                                                   |  |
| 52 | Blerta Dragusha    | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Anetare e komisionit te dhenies se grades shkencore doktor                                                                                                                                                    |  |
| 53 | Fatbardha Molla    | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Anetare e komisionit te dhenies se grades shkencore doktor                                                                                                                                                    |  |
| 54 | Peter Saraci       | FE | Departamenti Finance - kontabilitet | Pjesemarrs ne projektin SMART                                                                                                                                                                                 |  |

#### FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT

#### Pjesëmarrje në borde editoriale dhe projekte

| Nr | Emri i pedagogut   | Njësia Kryesore | Njësia Bazë                                     | Pjesëmarrje                                    |              |
|----|--------------------|-----------------|-------------------------------------------------|------------------------------------------------|--------------|
|    |                    |                 |                                                 | Në bordin editorial/ recensues të revistës     | Në projektin |
| 1  | Dizdari, V.        | FSHE            | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale | BUSH (seria e shkencave të edukimit)           |              |
| 2  | Dizdari, V.        | FSHE            | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale | Lente sociologjike                             |              |
| 3  | Fatbardha Osmanaga | FSHE            | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale | Buletini Shkencor USH, Shkencat e Edukimit     |              |
| 4  | Fatbardha Osmanaga | FSHE            | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale | ATINER (Instituti Grek per Edukimin e Kerkimin |              |

|   |                                                             |      |  |                                                 |                                                                                                                                                                     |
|---|-------------------------------------------------------------|------|--|-------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|   |                                                             |      |  |                                                 | "Standardizimi dhe Akreditimi i Mjeteve të Vlerësimit Psikologjik në Shqipëri: Sfidat, Boshlëqet dhe Perspektivat për Praktikën e Bazuar në Evidenca"               |
| 5 | Dizdari, V., Lesha, J., Hasmuaj, E., Osmanaga, F., Biba, G. | FSHE |  | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale | F.R.I.D.A.S                                                                                                                                                         |
| 6 | Dizdari, V., Hasmuaj, E., Biba, G., Topalli, B.             | FSHE |  | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale | E-Learning Gamified and Networked Training for Startupper, E-le.G.A.N.T.S., — ERASMUS-EDU-2022-CBHE- Projekti i perfunduar.                                         |
| 7 | Lumanaj, B.                                                 | FSHE |  | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale | Recensues, Buletini shkencor i USH-Seria e shkencave të edukimit.                                                                                                   |
| 8 | Lumanaj, B.                                                 | FSHE |  | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale | Recensues për Revistën shkencore Evropiane "European Scientific Journal, ESJ." ( Janë realizuar dy recensa një në muajin nëntor 2024 dhe një në muajin mars 2025 ). |
| 9 | Lumanaj, B.                                                 | FSHE |  | Departamenti i Psikologjisë dhe i Punës Sociale |                                                                                                                                                                     |

|    |                             |      |  |                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|----|-----------------------------|------|--|--------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 10 | Prof. as Dr. Eranda Hallumi | FSHE |  | Departamenti i Mësuesisë | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buletini Shkencor (Seria e Shkencave të Edukimit) të Ush "Luigj Gurakuqi". F10</li> <li>- Anëtare e bordit shkencor të seminarit ndërkombëtar Shkodra në shekuj "Trashëgimi e gjallë dhe fuqi krijuese në historinë kombëtare", 12-13 dhjetor 2024</li> <li>- Anëtare e bordit shkencor të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "Visaret e traditave dhe kujtesa që ndriçon historinë", 30-31 maj 2025</li> <li>- Zëvendës redaktore e revistës Multidisciplinary Research Journal "Olcinium", linku <a href="https://olcinium.me/publications/Volume_1_5.No.2(2025).pdf">https://olcinium.me/publications/Volume_1_5.No.2(2025).pdf</a></li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- "Edukimi është çelësi i zhvillimit", Lecce, Itali, 27 prill-10 maj 2025, <b>Anëtare projekti</b></li> <li>- ERASMUS+ project MOOC-Based Micro-Credentials for Teacher Professional Development (CRED4TEACH), 26-27 maj, 2025, Tallinn University në Estoni</li> <li>- Erasmus+ Consortium "Uniadrinon Italy" dhe Università Politecnica delle Marche.</li> </ul> |
| 11 | Prof. dr. Faunir Vadohej    | FSHE |  | Departamenti i Mësuesisë | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buletini Shkencor (Seria e Shkencave të Edukimit) të Ush "Luigj Gurakuqi"</li> <li>- Konferenca Shkencore Ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", ICSWSS 2024.</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 12 | Dr. Pranvera Kraja          | FSHE |  | Departamenti i Mësuesisë | <ul style="list-style-type: none"> <li>- "Universal Library of Arts and Humanities", ISSN: 3064-9943 (Online) <a href="https://ulopenaccess.com/ulpages/editorialboard/Ulahu,Manchester,NH,03103,USA">https://ulopenaccess.com/ulpages/editorialboard/Ulahu,Manchester,NH,03103,USA</a>.</li> <li>- "Horizon Research Publishing" (HRPUB), si recensuese e revistës shkencore "Universal Journal of Educational Research"(ISSN 2332-3213)</li> <li>- "European Journal of Education Studies" Bukureshti, Rumani.</li> </ul>                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |

|    |                  |      |                          |                                                                                                                                              |                                                                                                                                  |
|----|------------------|------|--------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 13 | Dr. Rina Muka    | FSHE | Departamenti i Mësuesisë | “Horizon Research Publishing” (HRPUB).<br>recensuese e revistës shkencore “Universal<br>Journal of Educational Research” (ISSN<br>2332-3213) |                                                                                                                                  |
| 14 | Dr. Megi Vjerdha | FSHE | Departamenti i Mësuesisë |                                                                                                                                              | PROJEKTI SHAPE -<br>Sport, Health and<br>People - a Western<br>Balkan University<br>Network. Koordinator<br>projektit UBT Kosove |



## ii) Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Roli i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (USH) në lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien është i përcaktuar qartë si një element thelbësor dhe i pandashëm i misionit të tij akademik. Strategjia e zhvillimit të USH-së (2022–2026) e konsideron universitetin si një institucion që mbështetet në dy shtylla të së njëjtës peshë dhe rëndësi: **mësimdhënia dhe kërkimi shkencor**. Kërkimi shkencor shërben si bazë për përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit dhe kurrikulave mësimore, duke e bërë mësimdhënien më të lidhur me nevojat bashkëkohore të tregut të punës dhe zhvillimet globale. Fakultetet rishikojnë vazhdimisht silabuset dhe përditësojnë literaturën përkatëse, duke siguruar një konceptim bashkëkohor të përmbajtjes. USH-ja synon të krijojë një raport të drejtë dhe efektiv midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Universiteti promovon një kulturë ku stafi akademik dhe studentët angazhohen aktivisht në kërkimin shkencor. USH synon rritjen e përfshirjes së studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë në kërkim shkencor. Kjo përfshirje synon formimin e shprehive të punës dhe metodave kërkimore, si dhe zhvillimin e aftësive analitike e kritike. Format e përfshirjes përfshijnë organizimin e konferencave studentore, ekspedita kërkimore (p.sh., eksplorim gjuhësor në terren), punime kërkimore individuale/grupi, si dhe aktivitete krijuese/artistike e ekspozita. USH mbështet gjithashtu integrimin e kërkimit shkencor në mësimdhënie duke zhvilluar projekte specifike dhe duke përmirësuar infrastrukturën:

- **Projekte Aplikative:** Kërkimi shkencor shpesh lidhet me zgjidhjen e problemeve konkrete rajonale, duke përfshirë studentët në projekte si Klinika e Ligjit (për ndihmën juridike falas), projektet e Fab-Lab (për ekonominë qarkulluese), dhe kërkimet mjedisore (p.sh., Monitorimi i Liqenit të Shkodrës). Këto projekte ndikojnë direkt në përmirësimin e praktikave dhe njohurive profesionale të studentëve. Ngritja dhe shfrytëzimi i aseteve si Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Wolf Dieter Sixl” dhe Laboratori Gjithëpërfshirës shërbejnë si mjete për kërkimin shkencor, duke ofruar praktika laboratorike të specializuara për studentët e programeve Bachelor dhe Master.

**Fakulteti I Shkencave Shoqërore** thekson si objektiv kryesor përforcimin e ndërveprimit ndërmjet kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Kjo synon krijimin e një lidhjeje më të ngushtë mes këtyre dy shtyllave, duke përdorur kërkimin si bazë për përmirësimin e cilësisë akademike.

### a. Përfshirja e Studentëve në Kërkim Shkencor

- **Përfshirja e Studentëve:** Angazhimi i studentëve synon përforcimin e aftësive të punës dhe metodave kërkimore shkencore. Kjo realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve kërkimore, përfshirjes së studentëve në projekte shkencore, si dhe aktiviteteve të klubeve studentore si “Arshi Pipa” dhe “Ernest Koliqi”. Një shembull konkret është organizimi i Konferencës Studentore mbi aspekte të Gjeografisë dhe Turizmit me 5 kumtesa nga studentët. Përfshirja është e theksuar edhe te doktorantët, të cilët kanë publikuar 3 artikuj shkencorë.

### b. Ndikimi i Kërkimit Shkencor në Kurrikulat Mësimore



• **Përditësimi i Kurrikulave:** Objektivat e mësimdhënies në FSHSH, si zhvillimi i aftësive kritike, përdorimi i teknologjive bashkëkohore dhe ndërkombëtarizimi, janë marrë parasysh gjatë procesit të hartimit të kurrikulave në të tre ciklet e studimit.

• **Përditësimi i Materialeve:** Ka një punë serioze për rishikimin e silabuseve, përditësimin e literaturës përkatëse dhe përmirësimin e materialeve mësimore çdo vit akademik. Kërkimi ndikon direkt në përditësimin e leksioneve dhe seminareve, duke siguruar një konceptim bashkëkohor të përmbajtjes.

• **Pajisja me Tekste të Reja:** Kërkimi shkencor i stafit kontribuon direkt në pasurimin e literaturës. Disa pedagogë kanë botuar me ISBN përmbledhje të përgatitura të leksioneve për studentët.

**Fakulteti I Shkencave Të Natyrës** e ka vendosur kërkimin shkencor në qendër të zhvillimit institucional, duke theksuar se kërkimi është baza e rritjes së cilësisë së mësimdhënies.

#### a. Përfshirja e Studentëve në Kërkim Shkencor

• **Përfshirja e Studentëve:** Një objektivi i FSHN-së është rritja e përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor, me qëllim stimulimin e mendimit kritik dhe aftësive analitike. Kjo përfshirje realizohet në disa mënyra:

◦ **Temat e Diplomës:** Përfshirja matet me 4 tema diplome në nivel Bachelor dhe 2 tema në Master Shkencor.

◦ **Bashkëpunime në Botime:** Studentët e Masterit shpesh janë bashkautorë në punimet dhe prezantimet shkencore me pedagogët. Për shembull, punimi “Perceptions of the third-Year Students... Regarding their Readiness to Face the Labor Market” u publikua në revistë si punim diplome i udhëhequr nga pedagogu Julian Kraja.

◦ **Projekte Kërkimore:** Në kuadër të projektit BIOSINT, 21 studentë janë trajnuar dhe certifikuar për kompetencat digjitale në edukimin biomedikal, duke rritur cilësinë e formimit të tyre profesional.

#### b. Ndikimi i Kërkimit Shkencor në Kurrikulat Mësimore

• **Modernizimi i Kurrikulave:** Kontributi i projekteve shkencore reflektohet në modernizimin e programeve të studimit, përmirësimin e përmbajtjes akademike dhe forcimin e infrastrukturës laboratorike.

**Integrimi i Përmbajtjes Kërkimore:** Përmes projekteve të ndërkombëtarizimit, si TCCWB (kompetencat transkulturore) dhe BIOSINT, janë realizuar tre module në gjuhën angleze për studentët, të cilat ndikojnë direkt në përmbajtjen e kurrikulave. Këto module, të dhëna nga lektorë nga Serbia, Bosnja dhe Mali i Zi, mbulojnë fusha si *Health Management in Times of Crisis*, *Medical Nutritional Therapy* dhe *Personalized Medicine*.

**Zhvillimi i Aftësive Praktike:** Kërkimi ndikon drejtpërdrejt në rritjen e përvojës praktike të studentëve. Përfitimi kryesor i qendrave kërkimore si Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Wolf Dieter Sixl” është ofrimi i praktikave laboratorike të specializuara për studentët e programeve Bachelor dhe Master, si dhe mbështetja e realizimit të punimeve të diplomës.

**Fakulteti I Shkencave Të Edukimit** e sheh kërkimin shkencor si thelbësor, duke theksuar integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor dhe rolin e kërkimit si bazë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

#### **a. Përfshirja e Studentëve në Kërkim Shkencor**

• **Përfshirja e Studentëve:** Përfshirja e studentëve në kërkim është thelbësore për **formimin e tyre profesional dhe qytetar**. Ky integrim arrihet përmes:

◦ **Mini-kërkime Shkencore:** Studentët inkurajohen të përfshihen në mini-kërkime shkencore si detyra individuale dhe në grup, duke nxitur analizën e literaturës.

◦ **Aktivitetet Krijuese dhe Ekspozita:** Përfshirja e studentëve të Arteve është shumë e lartë, si në organizimin e Ekspozitës vjetore “Expo 25” në Galerinë e Arteve (e cila shërben edhe për prezantimin e studentëve me tregun e punës) apo ekspozitave me tematikë psikologjike si “Psiko-ekspozitë”.

◦ **Projekte dhe Mobilitete:** Studentët janë përfshirë në projekte dhe mobilitete Erasmus+, ku 5 studentë të Psikologjisë ndoqën lëndë të profilit të psikologjisë dhe neuropsikologjisë, duke rritur kompetencat e tyre akademike dhe profesionale.

#### **b. Ndikimi i Kërkimit Shkencor në Kurrikulat Mësimore**

• **Integrimi Kërkimor:** Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të integruar punën shkencore në procesin e mësimdhënies, duke përfshirë materialet dhe përvojën nga projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.

• **Përditësimi Kurrikular:** Kërkimi shkencor ndikon drejtpërdrejt në hartimin, përditësimin dhe miratimin e syllabuseve. Përditësimi përfshin integrimin e literaturës bashkëkohore të bazuar në studime të fundit shkencore.

• **Produkte Didaktike:** Kërkimi i stafit ka prodhuar **tekste universitare** të rëndësishme, si libri “Psikologji Shëndeti” i Dr. Adelina Kakija dhe libri shkollor “Metodikë e edukimit muzikor” nga Doc. Roland Guli, të cilët shërbejnë si material bazë për lëndët e ciklit Bachelor dhe Master.

• **Inovacioni Pedagogjik:** Përfshirja aktive në projekte si CRED4TEACH (mikrokredenciale) dhe E-Le.G.A.N.T.S (të nxëniet të digjitalizuar) si dhe trajnimet për stafin mbi përdorimin e mjeteve kërkimore si VOSViewer, NVivo dhe Inteligjenca Artificiale, tregojnë rolin aktiv të kërkimit në zhvillimin e inovacioneve dhe metodave të avancuara të mësimdhënies

**Fakulteti i Drejtësisë** i shikon aktivitetet shkencore si bazë për ofrimin e një mësimdhënie cilësore e bashkëkohore.

#### **a. Përfshirja e Studentëve në Kërkim Shkencor**

• **Përfshirja e Studentëve:** Angazhimi i studentëve synohet për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe shkencore. Kjo realizohet në disa forma:

◦ **Konferenca Studentore:** Organizimi i Konferencës Studentore “Dita e Drejtësisë: Çështje të së Drejtës dhe të Jurisprudencës”.

◦ **Panel i Dedikuar:** Studentët janë përfshirë në një panel të dedikuar studentëve në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare CONFLAW24.

◦ **Praktika Kërkimore:** Përfshirja në veprimtari hulumtuese dhe praktike përmes Klinikës së Ligjit (për ndihmën juridike falas).

◦ **Gjyqe Imituese (Moot Court):** Pjesëmarrje në konkurse kërkimore si Telders International Law Moot Court Competition në Hagë.

#### **b. Ndikimi i Kërkimit Shkencor në Kurrikulat Mësimore**

- **Qasja Bashkëkohore:** Kërkimi shkencor ndikon në ofrimin e një mësimdhënieje bashkëkohore, duke përfshirë përditësimin e programeve mësimore, zgjerimin e komponentëve praktikë dhe përfshirjen e qasjeve ndërdisiplinore.

- **Kurrikula e Orientuar drejt Tregut:** Bazuar në analizat e tregut të punës, Fakulteti ka përmirësuar kurrikulën mësimore për programet aktuale.

- **Integrimi i Projekteve në Kurrikul:** Krijimi i Klinikës së Ligjit si një element kyç praktik, ndikon drejtpërdrejt në kurrikul, duke mundësuar zbatimin e legjislacionit për ndihmën juridike falas.

- **Trajnime Shkencore në Mësimdhënie:** Kërkimi shkencor i stafit në fushën e së drejtës së BE-së dhe anti-diskriminimit, si trajnimet e ndjekura nga pedagogët në Madrid dhe Trier, ndikojnë në pasurimin e ligjëratave dhe seminareve me njohuri të reja nga jurisprudenca evropiane.

**Fakulteti Ekonomik** thekson objektivat e tij për të rritur cilësinë e kërkimit, përfshirjen e studentëve dhe modernizimin e mësimdhënies.

**a. Përfshirja e Stafit dhe Studentëve:**

- Stafi aktivizohet në aplikime në projekte me financim nga BE dhe në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor ku përfshihen edhe mundësi bashkëpunimi me studentët.

- Përfshirja e studentëve realizohet kryesisht përmes mbështetjes akademike të doktoraturës në ETQ (Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm) nga projekti READ Diaspora, dhe përmes aktiviteteve si Ëorkshopi Doktorial.

- Studentët përfshihen në aktivitete të klubeve studentore si Smart Business Hub, Financa dhe Investime, Traveler Thinker, të cilat synojnë përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor.

- Aktivitete trainuese si “Fiskalitete” dhe “Data Analyst ne Cloud” synojnë lidhjen e praktikës me teorinë.

**b. Ndikimi i Kërkimit Shkencor në Kurrikula:**

- Kërkimi ndërkombëtar synohet të shfrytëzohet për zgjerimin e marrëveshjeve të reja me universitete të huaja dhe hapjen e diplomave të përbashkëta.

- Ngritja e laboratorit të financuar nga AKKSHI, **Fab-Lab**, synon kthimin e tij në një qendër rajonale mbi ekonominë qarkulluese, e cila do të ofrojë shërbime për të tretët dhe do të ndikojë në përditësimin e kurrikulave

**Fakulteti I Gjuhëve Të Huaja** tregon një orientim drejt rritjes së veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe përditësimit të metodave të reja kërkimore.

**a. Përfshirja e Stafit Akademik dhe Studentëve në Kërkim Shkencor**

- **Përfshirja e Studentëve:** Synohet përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor jo vetëm përmes aktiviteteve, por edhe nëpërmjet punimeve individuale të drejtuara nga pedagogët. Fokusi është gjithashtu te përgatitja e studentëve me aftësi në biznesin turistik dhe kulturor.

- **Përfshirja në Projekte Ndërkombëtare:** Rritja e numrit të studentëve dhe pedagogëve në projekte ndërkombëtare (si PLACOD, Mantenimento Cattedre di Italiano, etj.) është një objektivi i përhershëm.

**b. Ndikimi i Kërkimit Shkencor në Kurrikulat Mësimore**

- **Përditësimi Kurrikular:** Kërkimi shkencor ndikon në përditësimin me metoda të reja kërkimore dhe përditësimin e vazhdueshëm të literaturës bashkëkohore.
- **Zbatimi Aplikativ:** Kërkimi për gjuhët sektoriale ndikon në përgatitjen e studentëve me aftësi biznesi turistik dhe kulturor. Për shembull, projekti PLACOD (për promovimin digjital të Shkodrës) është aktivitet kërkimor që ofron përfitime në kurrikulat e Gjuhëve të Huaja të Aplikuara.
- **Lidhja me Sistemin Parauniversitar:** Përmes projekteve si “Videochallenge in English: Media Literacy” (financuar nga Ambasada Amerikane), kërkimi shkencor (Edukimi për Median dhe Informacionin) ndikon në mësimdhënie duke zhvilluar materiale didaktike dhe duke krijuar lidhje me publikun e sistemit parauniversitar

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka pasur një vit të suksesshëm në fushën e kërkimit shkencor, me angazhime të thelluara në fusha të ndryshme akademike dhe kërkimore. Aktivitetet shkencore të universitetit janë shtrirë në një gamë të gjerë tematikash, duke përfshirë botime shkencore, konferenca, dhe projekte kërkimore të rëndësishme.

**Fakulteti i Shkencave Shoqërore** - Veprimtaria kërkimore shkencore e FSHSH ka qenë e përqendruar në studime të gjuhës, letërsisë, historisë, gjeografisë, trashëgimi kulturore dhe sociale, me një angazhim të lartë individual të stafit dhe pjesëmarrje në rrjete kërkimore.

**Botime Shkencore dhe Titujt Akademikë** Në fushën e botimeve, Fakulteti ka prodhuar 3 monografi dhe 4 tekste universitare. Janë botuar gjithsej 43 artikuj në revista shkencore brenda vendit dhe 32 artikuj në revista ndërkombëtare (përfshirë ato me faktor impakti apo SCOPUS). Në kuadër të kualifikimit, pedagogu Gëzim Puka (Departamenti i Letërsisë) fitoi titullin Profesor i Asociuar gjatë vitit akademik 2024–2025.

**Pjesëmarrja në Veprimtari Shkencore dhe Bashkëpunime** FSHSH ka realizuar 111 kumtesa në konferenca brenda vendit dhe 58 kumtesa në konferenca jashtë vendit, nga të cilat 25 janë në vendet e Bashkimit Europian.

**Pjesëmarrja e Studentëve Doktorantë:** Tre doktorantë (Olta Smajli, Davida Marku, Andreas Dushi) realizuan 3 publikime shkencore në përmbledhjen “Studime shqiptare” dhe morën pjesë në konferencën shkencore ndëruniversitare “Arbëreshi shkodran Leonardo De Martino”. Gjithashtu, 11 doktorantë morën pjesë në sesionin “Dita e doktorantit” gjatë Konferencës Ndërkombëtare “Trevë e Veriut” (30-31 Maj 2025, Shkodër).

Një pjesë e rëndësishme e prodhimit shkencor të FSHSH është përqendruar te studimet letrare dhe gjuhësore, të cilat materializohen në monografi, tekste dhe artikuj:

- **Studimet Letrare dhe Krijuese:** Botimet përfshijnë tema të detajuara si analiza e veprës letrare të shkrimtarit bashkëkohor shqiptar Ridvan Dibra (e cila ishte objekt i një konference shkencore), si dhe përgatitjen e monografive për figura të rëndësishme letrare si Martin Camaj. Gjithashtu, planifikohet botimi i përmbledhjeve studimore si “Letërsi e Rilindjes” dhe “Autorë dhe vepra II”.
- **Studimet Gjuhësore:** Kërkimi përfshin analiza specifike, siç është puna për botimin e monografisë “Variacioni i strukturave rrokjesore në gjuhën shqipe”. Në nivel akademik, pedagogë

si Merita Hysa dhe Rrezarta Draçini kanë kontribuar në hartimin e “Fjalorit të madh të Gjuhës Shqipe”.

- **Trashëgimia Etnokulturore dhe Turizmi:** Një projekt kyç i PKKZH i fituar nga AKKSHI dhe në zbatim (Janar 2025) është “Horizontet Digjitale të Transhumancës (jetës baritore)”, i cili synon ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë etnokulturore të Alpeve Shqiptare për zhvillim të qëndrueshëm.

- **Studimet Historike dhe Kujtesa:** Studimet fokusohen te dokumentimi i burimeve, siç dëshmohet nga projekti “Shtypi në Shkodër nga fillimet e tij deri në vitin 1920, në kohë digjitale”. Një tjetër temë e rëndësishme kërkimore është “Turizmi i errët në Shqipëri”, i cili analizon konceptin e turizmit si pjesë e kujtesës historike dhe zhvillimit kulturor, në krahasim me përvojat e vendeve të Evropës Lindore.

- **Veprimtari Shkencore:** Qendra Albanologjike organizoi Seminarin “Shkodra në shekuj” (12-13 Dhjetor 2024, Shkodër), dhe Konferencën shkencore ndërkombëtare “Treva e Veriut “Visaret e traditave dhe kujtesa që ndriçon historinë” (30-31 Maj 2025, Shkodër).

- **Mjedisi dhe Turizmi:** Kumtesat e studentëve në Konferencën Studentore të Majit 2025 trajtonin tema si Problemet mjedisore të krijuara nga turizmi masiv në Parkun Kombëtar të Thethit, Agroturizmi si model për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në Pukë.

- **Zhvillimi Rajonal:** Pjesëmarrja në veprimtari, si forumi “Ekoturizmi gjithëvjetor në parkun kombëtar Alpet e Shqipërisë” dhe hartimi i planit të integruar të menaxhimit për Rezervatin natyror të menaxhuar të Liqenit të Shkodrës (2024), reflektojnë fokusin te potencialet e natyrës dhe ekoturizmit.

- **Diskursi Publik dhe Etika:** Projekti “Përtej fjalëve: Strategji për parandalimin e dhunës verbale në hapësirat publike dhe online” (mbështetur nga USH, Prill–Maj 2025) solli një studim mbi format e dhunës verbale dhe ndikimin e saj në komunikimin publik.

- **Migracioni dhe Qeverisja:** Kërkimi adreson ndërvarësitë midis migracionit, kënaqësisë me jetën dhe tolerancës ndaj korrupsionit dhe autokracisë në shoqëritë tranzitore, në kuadër të projektit READ. Gjithashtu, është aplikuar për projekte që lidhen me migrations, de-colonisation, slavery and multicultural European societies (Projekti DeGazes, Shtator 2025)

**Fakulteti i Shkencave Të Natyrës** ka fokusuar produktet e kërkimit shkencor në shëndetësi, mjedis dhe infrastrukturë laboratorike, duke nxitur studime të lidhura ngushtë me praktikën klinike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Botime Shkencore dhe Titujt Akademikë** Stafi ka realizuar 23 botime në revista shkencore jashtë vendit dhe 19 botime në revista shkencore brenda vendit. Shumë nga këto botime janë në revista ndërkombëtare të indeksuara, si Open Public Health J (Scopus) dhe International Journal of Ecosystems and Ecology Science (IJEES). FSHN ka realizuar 71 konferenca nga të cilat 39 janë në vendet e bashkimit Europian dhe OECD.

- **Bashkëpunime Kombëtare/Rajonale:** FSHN mori pjesë si partner në konferencën ndërkombëtare “The 2nd International Congress of Healthcare Professionals” në Prishtinë, Kosovë (5–6 Prill 2024), në bashkëpunim me Odën e Infermierëve të Kosovës (Rajonal).

• **Leksione të Hapura:** Prof.as.dr. Zamira Shabani (Departamenti i Lëndëve Klinike) mbajti leksion në USH, Shkodër, mbi vetë-ekzaminimin dhe Kancerin e Gjirit (30 Tetor 2024 dhe 30 Tetor 2025). U zhvilluan leksione të hapura nga Ph.D. Daniele Conte (University of Rome “Foro Italico”) në Shkodër (16–22 Mars 2025).

Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) e ka përqendruar veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore në tre boshte kryesore: **Shëndetësia dhe Mjekësia Aplikative, Mjedisi, Ekologjia dhe Biodiversiteti**, si dhe **Shkencat Ekszakte dhe Teknologjitë Aplikative**, shpesh duke i lidhur këto fusha me zhvillimin e qëndrueshëm dhe sfidat rajonale.

• **Shëndeti i Personelit Mjekësor:** Studimet kanë adresuar çështje si sindroma e djegies profesionale (burnout) dhe lodhja emocionale tek infermierët e kirurgjisë dhe profesionistët mjekësorë në spitalin rajonal të Shkodrës. Gjithashtu janë hulumtuar çrregullimet muskulaskelitore (MSDs) dhe faktorët e riskut tek stafi i infermierisë.

• **Shëndeti Mendor dhe Social:** Tema të tjera përfshijnë efektet e përdorimit të smartfonëve tek studentët e universitetit, si dhe vlerësimi i ankthit para-operativ tek pacientët. Ka pasur gjithashtu studime mbi vlerat altruiste dhe motivimin për vullnetarizëm tek studentët e Infermierisë, Mamisë dhe Fizioterapisë.

• **Fizioterapia dhe Rehabilitimi:** Studime të specializuara janë realizuar mbi efektivitetin e ushtrimeve specifike për skoliozën (PSSS) tek adoleshentët, shpesh në formë rishikimi sistematik të literaturës.

• **Fizika Mjekësore dhe Siguria Radiologjike:** Kërkimi përfshin fushën e dozimetrisë termolumineshente dhe monitorimin e ekspozimit ndaj rrezatimit jonizues të stafëve mjekësore (në kuadër të projektit PIKSH “Ngritja e Laboratorit Dozimetrik Sekondar”).

• **Turizmi Shëndetësor:** Kërkimi është lidhur me aspektet gjeografike të sëmundjeve siç është shpërndarja gjeografike e pacientëve me sëmundje kongjenitale të zemrës në Shkodër, duke e analizuar këtë si një segment të rëndësishëm të turizmit shëndetësor (Health Tourism).

• **Cilësia e Ujërave dhe Ndotja:** Kërkimet janë fokusuar te monitorimi i integruar i ndotësve dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave në ekosisteme rajonale, si Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna, duke analizuar ndikimin e ndotjes (p.sh., nga metalet e rënda) në biodiversitet dhe turizëm të qëndrueshëm.

• **Mbetjet dhe Ndotja Detare:** Një temë e adresuar është vlerësimi i ndotjes makroplastike përgjatë vijës turistike bregdetare të Velipojës dhe Shëngjinit. Kërkimet përfshijnë edhe cilësinë mikrobiale të ujërave dhe rërës së plazheve.

• **Ruajtja e Biodiversitetit:** Studimet mbulojnë çështje të ruajtjes së biodiversitetit lumor dhe menaxhimit efektiv të specieve dhe habitateve detare përballë ndryshimeve klimatike dhe peshkimit intensiv, në kuadër të projektit ndërkombëtar SPEEDY. Gjithashtu janë analizuar habitatet dhe speciet më të rëndësishme për ruajtje në Liqenin e Shkodrës, sipas Direktivave Evropiane.

• **Ekotoksikologjia dhe Ushqimi:** Kërkimi përfshin vlerësimin e ekotoksicitetit të ndotësve emergjentë (Emerging Contaminants) në peshq, si dhe analiza mbi apikulturën (bletaria) dhe potencialin e saj për zhvillimin ekonomik dhe turizmin rural.

- **Matematikë dhe Informatikë:** Temat e publikuara përfshijnë teoremat e pikës fikse (fixed point theorems) në hapësirat metrike Fuzzy. Kërkimi gjithashtu adreson integrimin e TIR (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit) dhe mendimit kompjuterik me mësimdhënien e matematikës në shkollat e mesme.

- **Zhvillimi i Kurrikulave dhe AI:** Studimet kanë përfshirë analizën e përmbajtjes së lëndëve të algjebërës në tekstet e klasës së 9-të në Shqipëri në mbështetje të rezultateve PISA. Gjithashtu, janë prezantuar punime mbi ndikimin ekonomik dhe sfidat etike të Inteligjencës Artificiale në Ballkanin Perëndimor.

**Fakulteti i Shkencave Të Edukimit** ka fokusuar produktet e kërkimit të zhvillimi profesional, mirëqenia psiko-sociale dhe veprimtaria krijuese artistike.

FSHE ka realizuar 1 libër universitar (“Psikologji Shëndeti”) nga Dr. Adelina Kakija dhe 1 libër shkollor (“Metodikë e edukimit muzikor”) nga Doc. Roland Guli. Në total, janë botuar 18 artikuj në revista shkencore, prej të cilave 11 janë të indeksuara, duke përfshirë 6 artikuj në revista ndërkombëtare të indeksuara (Scopus/IF). Stafi ka realizuar 57 kumtesa në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, nga të cilat 25 në vendet e Bashkimit Europian dhe OECD.

#### **Veprimtari Shkencore/Artistike të Organizuara dhe Bashkëpunime**

- **Ekspozita Krijuese Artistike (Vendor):** FSHE (Departamenti i Arteve) organizoi Ekspozitën vjetore “Expo 25” (2025) në Galerinë e Arteve, Shkodër, si dhe “Psiko-ekspozitë” (Shkurt 2025). Gjithashtu, u realizua Ekspozita e studentëve të Arteve në hollin e Kinema Republika (15 Prill 2025), në bashkëpunim me qendrën COD të Kryeministrit.

- **Leksione të Hapura Ndërkombëtare (brenda vendit):** U mbajt leksion i hapur mbi “Klimën organizative dhe punën në distancë” nga Prof. Ferdinando Toscano (Universiteti “Luigi Vanvitelli”). Gjithashtu, u realizua leksioni “Festivali i Muraleve dhe transformimi i qytetit të Ferizajt” nga Dekane Lebibe Topalli (21 Maj 2025).

- **Trajnime Profesionale (Vendor):** Pedagogët E. Halluni dhe P. Kraja vazhdojnë angazhimin si trajnere në Shkollën e Drejtorëve CSL (viti akademik 2024-2025)

Fushat kryesore tematike të botimeve dhe pjesëmarrjeve në konferenca të Fakultetit të Shkencave të Edukimit (FSHE) shtrihen në studimet sociale, psikologjike, pedagogjike, si dhe në fushën e arteve dhe edukimit fizik, shpesh duke u përqendruar te **mirëqenia, edukimi gjithëpërfshirës dhe ndikimi i teknologjisë**.

- **Shëndeti Mendor dhe Socializimi:** Tematika të rëndësishme përfshijnë shëndetin mendor, arsimimin dhe zhvillimin akademik të studentëve. Kërkimi ka trajtuar gjithashtu etikën profesionale dhe qasjet psikosociale në komunitet.

- **Efektet e Teknologjisë:** Studimet kanë analizuar ndikimin e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në procesin e të nxënës dhe në jetën sociale.

- **Sfidat Pas-Pandemike:** Janë paraqitur punime mbi shëndetin mendor dhe sfidat e periudhës pas-pandemike.

- **Inovacioni Pedagogjik:** Janë analizuar tema si integrimi i teknologjisë pedagogjike, si dhe përdorimi i Inteligjencës Artificiale në procesin mësimor.



- **Edukimi Gjithëpërfshirës:** Prioritet mbetet kërkimi mbi edukimin gjithëpërfshirës dhe praktikat në shkollat shqiptare.

- **Publikimet:** Stafi ka botuar artikuj mbi mirëqenien psikologjike të studentëve pas pandemisë, si dhe libra shkollorë dhe universitarë, si “Psikologji Shëndeti” dhe “Metodikë e edukimit muzikor”.

- **Shëndeti dhe Aktiviteti Fizik:** Tematika kryesore përfshijnë rëndësinë e qëndrueshmërisë muskulare në performancën fizike dhe promovimin e shëndetit, si dhe aftësitë ndijimore-perceptive dhe koordinative të fëmijëve.

- **Analiza Sportive:** Studimet kanë adresuar analiza të specializuara mbi parametrat teknikë-taktikë në volejball e futboll.

- **Studimet mbi Artin:** Stafi ka kontribuar në botime mbi trashëgiminë katolike të Shqipërisë dhe identitetin në kontekstin gjuhësor dhe metafizik.

**Fakulteti I Drejtësisë** ka prodhuar punë shkencore me fokus te kualifikimi i stafit, Integrimi European dhe aplikimi i ligjit.

- **Botime Shkencore dhe Titujt Akademikë**

Stafi ka publikuar **9 artikuj shkencorë** gjatë vitit akademik 2024–2025. Botimet përfshijnë tema mbi përdorimin e inteligjencës artificiale në procesin gjyqësor dhe të drejtën ndërkombëtare, si punimi i Prof.as. PhD. Paulina Guli në **Juridical Tribune** (Scopus). Stafi I FD ka qenë pjesëmarrë në 37 konferenca nga të cilat 15 në vendet e Bashkimit European dhe OECD.

Në kuadër të kualifikimit, FD shënoi arritje të larta me fitimin e gradës Doktor i shkencave nga dy anëtarë, Arenca Trashani (27 Mars 2025, Tiranë) dhe Ambra Kokaj (19 Qershor 2025, Tetovë, Maqedonia e Veriut), si dhe titullin Profesor i Asociuar nga Senada Reçi.

- Projekte të Fituara dhe të Realizuara

- **Konferenca Shkencore Ndërkombëtare (CONFLAW24):** Projekt i realizuar (5 Dhjetor 2024, Shkodër). U organizua në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Juridike, Universiteti i Firences (Ndërkombëtar). Anëtarë të stafit FD ishin pjesë e Komitetit Shkencor.

- **Konferenca Studentore “Dita e Drejtësisë”:** Projekt i realizuar, hartuar nga Departamenti i të Drejtës Publike (8 Maj 2024).

- **Projekti “Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike falas...”:** I implementuar nga Departamenti i të Drejtës Publike dhe Klinika e Ligjit (Vendor).

- Pjesëmarrja në Veprimtari Shkencore dhe Bashkëpunime

- **Gjyqet Imituese (Ndërkombëtar): 3 studentë dhe 2 pedagoge** (Dr. M. Rukaj dhe A. Trashani) morën pjesë në Telders International Law Moot Court Competition në Hagë, Hollandë (4–7 Qershor 2025).

- **Trajnime Ndërkombëtare:** Prof. as. Dr. Florian Bjanku mori certifikatë pjesëmarrjeje nga Academy of European Law (ERA) në Madrid, Spanjë (2–3 Qershor 2025) dhe në Trier, Gjermani (10–11 Mars 2025).

- **Leksione të Hapura/Tryeza Diskutimi (Vendor):** U organizua leksion i hapur “EU integration and Rule of Law lessons from previous enlargements rounds” nga prof. Jean Michel de Waele (4 Nëntor 2025, Shkodër), dhe forume mbi dhunën me bazë gjinore (4 Mars 2025).



Fushat kryesore tematike të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca të stafit akademik janë theksuar në çështjet ligjore të lidhura me **integrimin evropian, të drejtat e njeriut, reforma në drejtësi dhe studimet krahasuese të së drejtës publike.**

- **Harmonizimi i Legjislacionit:** Shumica e punimeve të prezantuara në konferenca janë fokusuar te Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me të drejtën e BE-së dhe eksperiencat e vendeve të tjera, siç dëshmohet nga Konferenca Shkencore Ndërkombëtare CONFLAW24.

- **Temat Specifike:** Janë hulumtuar çështje konkrete të këtij procesi, duke përfshirë Harmonization of Albanian legislation with Chapter 16 of the Acquis Communautaire (R. Dodani), Direktiva e BE-së Nr. 1203/2024 mbi mbrojtjen penale të mjedisit dhe impakti i saj në legjislacionin penal shqiptar (E. Furramani), dhe Approximation of intellectual property with European Union Law. The case of Albania (M. Rukaj).

- **Implikimet e Anëtarësimit:** Kërkimi ka adresuar edhe implikimet afatgjata, siç është Albania's Path to EU Accession and Long-Term Property Rights Implications (F. Bjanku).

- **Sistemet Sociale dhe Migracioni:** Botimet kanë trajtuar përshtatjen e sistemit të mbrojtjes sociale të Shqipërisë me standardet evropiane dhe të drejtat e punës për shtetasit e vendeve të treta në BE (F. Arrinaj).

- **Roli i Institucioneve Gjyqësore dhe Kushtetuese:** Hulumtimet përfshijnë tema mbi pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Lindore, roli i amicus curiae i Komisionit të Venecias, dhe analiza specifike mbi institucionet historike si Këshilli i Lartë Kontrollues sipas normativës kushtetuese të 1925-ës (P. Guli).

- **Analiza Kushtetuese Historike:** Stafi mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare mbi "Aspetti di storia del diritto pubblico albanese: la Costituzione del 1925" të organizuar nga Universiteti i Bergamos, ku u trajtuan çështje si mandati i deputetit dhe liria e fjalës dhe e shtypit në Kushtetutën e 1925-ës.

- **Qeverisja dhe Integrimi Rajonal:** Kërkimi ka trajtuar sfidat e integritetit Evropian të Shqipërisë dhe Malit të Zi në nivelin e pushtetit vendor (A. Kokaj, G. Kokaj).

- **Inteligjenca Artificiale (AI) dhe Gjyqësori:** Temat përfshijnë përdorimin e inteligjencës artificiale në procesin gjyqësor dhe parimin e pavarësisë së gjyqësorit (P. Guli), si dhe përdorimi i inteligjencës artificiale për identifikimin biometrik sipas Regullores së BE-së (E. Furramani).

- **E Drejta Digjitale dhe Privatësia:** Janë hulumtuar aspekte si Constructing children's digital identity: a Private Law perspective (E. Bari) dhe Privacy and Protection of Legal Persons' Personal Data (E. Kuluri).

|    |                        |                                                        |                                                                                                   |  |               |       |                      |                                             |                                                         |
|----|------------------------|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|--|---------------|-------|----------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------------------|
| 58 |                        |                                                        | Master Profesional në "Mësues Muzike"                                                             |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | Urdhër nr. 581, datë 04.10.2022,            |                                                         |
| 59 | FAKULTETI I DREJTËSISË | -Departamenti i të drejtës ndërkombëtare dhe Europiane | Program i Integruar i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi                  |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | Urdhër nr. 191, datë 03.07.2020             |                                                         |
| 60 |                        | - Departamenti i së Drejtës Publike                    | Master i Shkencave në "E Drejta Private dhe e Biznesit"                                           |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | VKM nr. 1162, datë 25.11.2009               |                                                         |
| 61 |                        | -Departamenti i së Drejtës Civile                      | Master i Shkencave në "E Drejta Kushtetuese dhe Administrative"                                   |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | VKM nr. 682, datë 25.08.2010                |                                                         |
| 62 | FAKULTETI EKONOMIK     | Financë – Kontabilitetit                               | Bachelor në "Financë – Kontabilitetit"                                                            |  | Cikli i Parë  | Aktiv | Në proces akreditimi | Shkresë MASH nr. 4390 Prot. datë 23.10.2000 | Studim dhe interpretim të dhenash nga Instituti për RVB |
| 63 |                        |                                                        | Master i Shkencave në "Kontabilitetit"                                                            |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | UMASH nr. 395, datë 10.08.2011              |                                                         |
| 64 |                        |                                                        | Master i Shkencave në "Financë"                                                                   |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | UMASH nr. 395, datë 10.08.2011              |                                                         |
| 65 |                        |                                                        | Master Profesional në "Financë – Bankë"                                                           |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | UMASH nr. 503, datë 18.10.2012              |                                                         |
| 66 |                        |                                                        | Master Profesional në "Menaxhimi Financiar, Kontabiliteti dhe Kontrolli në Administratën Publike" |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | UMASH nr. 702, datë 19.10.2018              |                                                         |
| 67 |                        | Administrim - Biznes                                   | Bachelor në "Administrim – Biznes"                                                                |  | Cikli i Parë  | Aktiv | Në proces akreditimi | VKM nr. 349, datë 10.08.1992                |                                                         |
| 68 |                        |                                                        | Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"                                                       |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | UMASH nr. 395, datë 10.08.2011              |                                                         |
| 69 |                        |                                                        | Master Profesional në "Administrim Biznes"                                                        |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | UMASH nr. 503, datë 18.10.2012              |                                                         |
| 70 |                        | Turizëm                                                | Cikli i tretë "Doktoratë" në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"                                  |  | Cikli i Tretë | Aktiv |                      | Urdhër nr. 174, datë 04.04.2022             |                                                         |
| 71 |                        |                                                        | Bachelor në "Turizëm"                                                                             |  | Cikli i Parë  | Aktiv | Në proces akreditimi | MAS vendim 1803/I datë 05.06.2001           |                                                         |
| 72 |                        |                                                        | Master i Shkencave në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm"                                        |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | VKM nr. 1370, datë 10.10.2008               | Studim dhe interpretim të dhenash nga Instituti për RVB |
| 73 |                        |                                                        | Master Profesional në Trashëgimi Kulturor dhe Menaxhim Turizmi                                    |  | Cikli i Dytë  | Aktiv |                      | UMASH nr. 503, datë 18.10.2012              |                                                         |

|    |                              |                |                                                   |  |              |       |                                            |
|----|------------------------------|----------------|---------------------------------------------------|--|--------------|-------|--------------------------------------------|
| 74 | FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA | Gjuhë Angleze  | Bachelor në "Gjuhë Angleze"                       |  | Cikli i Parë | Aktiv | VKM nr. 300, datë 21.06.1994               |
| 75 |                              |                | Master Profesional në "Mësuesi në Gjuhë Angleze"  |  | Cikli i Dytë | Aktiv | VKM nr. 1291, datë 24.09.2008              |
| 76 |                              | Gjuhë Gjermane | Bachelor në "Gjuhë Gjermane"                      |  | Cikli i Parë | Aktiv | Shkresë MASH Nr. 960 prot. datë 11.03.1996 |
| 77 |                              |                | Master Profesional në "Mësuesi në Gjuhë Gjermane" |  | Cikli i Dytë | Aktiv | VKM nr. 1291, datë 24.09.2008              |
| 78 |                              | Romanistikës   | Bachelor në "Gjuhë Frënge"                        |  | Cikli i Parë | Aktiv | VKM nr. 596, datë 22.09.2005               |
| 79 |                              |                | Master Profesional në "Mësuesi në Gjuhë Frënge"   |  | Cikli i Dytë | Aktiv | VKM nr. 1333, datë 01.10.2008              |
| 80 |                              |                | Bachelor në "Gjuhë Italiane"                      |  | Cikli i Parë | Aktiv | VMASH nr. 146, datë 04.08.1998             |
| 81 |                              |                | Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë Italiane" |  | Cikli i Dytë | Aktiv | VKM nr. 28, datë 20.01.2001                |

5 programe pasive

6 programe te riorganizuara

iii) Përshtatshmëria e programeve të studimit në secilin fakultet me misionin e institucionit, realizimi i synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhja e rëndësia e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.

Programet e studimit të ofruara nga Universiteti i Shkodrës janë në të njëjtën linjë me misionin dhe objektivat strategjike të tij, konkretisht atë të mësimdhënies, e cila synon në: arritjen e standarteve të larta në mësimdhënie, si dhe aplikimin e standarteve të larta në vlerësimin institucional dhe programeve të studimit.

Këto programe studimi ofrohen në përputhje me Statutin e USH-së miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, nr. 366, dt. 05/07/2018 i ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 57 datë 21. 02. 2025, Nr. 770 Prot. "Për miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (miratur nga MAS) dhe Rregulloren e USH-së miratuar me Vendimin e Senatit Akademik (SA) të USH-së nr. 182, datë 28/05/2018 "Për miratimin e Rregullores së studimeve në USH", ndryshuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 218/1, dt.22/01/2020; Nr. 145 /2022 dhe Nr. 130/2023, ndyshuar me Vendim Nr. 280 datë 19. 1. 2024.

#### **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**

Objektivat e mësimdhënies për vitin akademik 2024-2025 në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të USH-së dhe ofron:

Programe bashkëkohore studimi, të cilat garantojnë përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat dhe profilin e përcaktuar. Ato janë ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e USH, nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe kanë të integruar përvojën më të mirë bashkëkohore të huaj dhe vendase.

#### **Fakulteti i Shkencave të Natyrës**

Misioni i mësimdhënies në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN) është i harmonizuar me misionin dhe objektivat institucionale të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. FSHN synon përgatitjen e individëve të aftë profesionalisht dhe shkencërisht, të cilët kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë përmes dijes, inovacionit dhe praktikave profesionale bashkëkohore. Në qendër të strategjisë së mësimdhënies qëndron rritja e cilësisë së proceseve akademike, përmirësimi i vazhdueshëm i praktikave pedagogjike dhe fuqizimi i rolit të stafit akademik si kontribues të rëndësishëm në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

#### **Fakulteti i Shkenave të Edukimit**

Programet e studimit pranë FSHE-së janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e USH-së. Objektivat e programeve, gjithashtu, janë në harmoni me Strategjitë e USH-së si dhe janë në funksion të realizimit të objektivave të saj. Në programet e studimeve janë të paraqitura rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Programet e studimeve përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Procesi i mësimdhënies në FSHE i orientuar me misionin e Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”, ka synuar në realizimin e qëllimeve si:

- Të formojë specialistë të lartë të aftë dhe konkurues në tregun e punës.
- Të japë njohuri bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike sipas programeve të studimit.
- Të nxisë kërkimin shkencor.
- Të kontribuojë në ngritjen profesionale të studentëve që të ndikojnë në komunitet për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, etj.

#### **Fakulteti i Drejtësisë**

Programet e studimit të ofruara nga ky fakultet janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat strategjike të Universitetit të Shkodrës, veçanërisht në fushën e mësimdhënies, e cila synon arritjen e standardeve të larta akademike dhe zbatimin e praktikave bashkëkohore.

Këto programe ofrohen në përputhje me Statutin e Universitetit të Shkodrës, miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 366, datë 05.07.2018, Vendimin nr. 52, datë 21.02.2025 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e USH-së”, si dhe me “Rregulloren e Studimeve”, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 182, datë 28.05.2018 “Për miratimin e Rregulloreve të studimeve në USH”, e ndryshuar me vendimet e Senatit Akademik nr. 218/1, datë 22.01.2020; nr. 145/2022, ndryshuar me Vendim nr. 280 datë 19. 1. 2024, nr. “Për disa ndryshime në Rregulloren e Studimeve në Universitetin e Shkodrës”.

Fakulteti i Drejtësisë kryen studime në mënyrë periodike mbi tregun lokal e rajonal të punës për programet e studimit që ofron. Bazuar në anketime të ndryshme të realizuara në shkollat e mesme të bashkive të Qarkut Shkodër si edhe në institucione publike apo subjekte private, konstatohet të ketë një qasje pozitive mbi programet e studimit të ofruara nga FD si dhe në përputhje me nevojat e tregut.

Gjatë viteve të fundit rezulton të ketë kërkesë permanente për regjistrime në Fakultetin e Drejtësisë, në të tre programet e studimit që ofron FD, por sidomos në programin e integruar 5-vjeçar “Master i Shkencave në Drejtësi”, duke dëshmuar ndalimin e uljes së numrit të studentëve të regjistruar rishtaz.

Analiza e tregut të punës tregon një nevojë të vazhdueshme për juristë të kualifikuar në administratën publike, institucionet e sistemit të drejtësisë, sektorin privat, organizatat ndërkombëtare dhe në profesionet e lira si avokatia apo noteria. Kërkesa për profesionistë me

njohuri të thelluara në fushat e së drejtës civile, penale dhe administrative është e lartë dhe e qëndrueshme, duke reflektuar nevojën për profesionistë të kualifikuar dhe me aftësi të avancuara profesionale.

Bazuar këtyre analizave të tregut të punës, Fakulteti i Drejtësisë, vazhdimisht ka përmirësuar kurrikulën mësimore për programet aktuale që ofron si dhe është angazhuar në hapjen e programeve të reja, të cilat pritet të miratohen në vazhdim.

#### **Fakulteti Ekonomik**

Programet e studimit të FE-së janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e USH-së. Objektivat e programeve, gjithashtu, janë në harmoni me Strategjitë e USH-së si dhe janë në funksion të realizimit të objektivave të saj. Në programet e studimeve janë të paraqitura rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Programet e studimeve përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Për programet që ofrohen është realizuar dhe janë në proces:

- Realizimi i studimit të tregut të punës
- Rishikimi i kurrikulës së programeve ekzistuese
- Forcimi i cilësisë së mësimdhënies
- Zhvillimi profesional i stafit akademik
- Rritja e praktikave profesionale
- Rritja e mobilitetit studentor
- Nxitja e kërkimit të lidhur me mësimdhënien
- Nderkombetarizimi
- Hapja e programeve të reja në ciklin e dytë

#### **Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

Mision i rëndësishëm për vitin akademik 2024-2025 ka qënë jo vetëm garantimi dhe ruajtja e cilësisë së mësimin, por gjithashtu edhe prezantimi dhe organizimi i sa më shumë aktiviteteve me në qendër studentët për t'i bërë pjesë aktive bashkëvepruese dhe ndërvepruese. Evidencë për këtë është realizimi me sukses i procesit mësimor.

Programet lëndore janë hartuar në përputhje të plotë me objektivat e planit mësimor për secilin program studimi Bachelor dhe Master. Ato u përditësuan me burime dhe materiale të reja, të cilat u zbatuan në leksione dhe seminare.

Rol të rëndësishëm në realizimin e objektivave luajnë edhe metodat interaktive të mësimdhënies të përdorura nga pedagogët me në qendër studentin. Nevojat e studentëve për njohuri dhe ndërtimi i këtyre njohurive mbi ato ekzistuese janë principe që zbatohen në temat e ndryshme të orëve të mësimin.

**e. Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.**

*a. Të dhëna në lidhje me ndryshimet në aktet e brendshme të IAL-së, si rregulloret, kodet e etikës, statutet e IAL-së ose të fakulteteve, duke parashtruar ndryshimet e bëra .*

**I. Senati Akademik me Vendim Nr. 21 datë 23. 01. 2024, Nr. 235 Prot. “Për miratimin e ndryshimit në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës” me këtë përmbajtje:**

1. Të miratojë ndryshimin në Rregulloren e FSHN-së, Neni 11, pika 1 si vijon: "Aktualisht Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka në përbërjen e tij 6 (gjashtë) njësi bazë, 5 (pesë) departamente dhe 1 (një) qendër kërkimore që janë:

- a. Departamenti i Matematikës
- b. Departamenti i Biologji-Kimisë
- c. Departamenti Fizikës
- d. Departamenti i Lëndëve Paraklinike
- e. Departamenti i Lëndëve Klinike
- f. Qendra Kërkimore Shkencore e Studimit të Ujrave të Rajonit të Shkodrës".

## **II. Senati Akademik me Vendim Nr. 280 datë 19. 1. 2024, Nr. 4244 Prot. "Për disa ndryshime në Rregulloren e Studimeve në Universitetin e Shkodrës" ka bërë këto ndryshime:**

Të shtojë në nenin 4, pas pikës 2, të Rregullores së Studimeve, pikën 2.1, si vijon:

### **2.1 Pezullimi i afatit të studimeve**

Studenti mund të pezullojë studimet në çdo kohë të vitit për këto raste:

- a. kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport komisioni mjeko-ligjor;
- b. në raste fatkeqesish familjare dhe/ ose kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara këto nga zyrat përkatëse të pushtetit vendor;
- c. kur dënohet me burgim për një vepër penale, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale;
- d. në rastet kur studenti ndjek studime e kualifikime në institucione të tjera të arsimit të lartë të huaj, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Rregullore.
- e. në çdo rast tjetër i cili sipas vlerësimit të Dekanit dhe Rektorit përbën shkak të ligjshëm dhe objektiv për pezullimin e studimeve.

2.1.1 Kohëzgjatja maksimale e periudhës së pezullimit të studimeve është jo më shumë se 3 vite akademike, duke filluar nga e nesërmja e miratimit të pezullimit sipas procedurës së përcaktuar.

2.1.2 Kërkesa për përfitimin e të drejtës së pezullimit të studimeve bëhet me shkrim nga vetë studenti i interesuar, i cili ka detyrimin ta mbështesë me dokumentacionin provues.

2.1.3 Miratimi përfundimtar i kërkesës për pezullimin e afatit të studimeve kryhet nga Rektori i USH-së, pas dhënies së miratimit paraprak nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse.

2.1.4 Kthimi i studentit, pas pezullimit të afatit të studimeve bëhet në fillim të vitit akademik, por jo e vonë se një muaj pas përfundimit të afatit 3- vjeçar.

2.1.5 Studentit që ka pezulluar studimet, i njihen të gjitha detyrimet e shlyera më parë. Ai i nënshtrohet detyrimeve të planit mësimor që gjen pas rifillimit të studimeve.

2.1.6 Gjatë periudhës së pezullimit, afatet e përcaktuara për kohëzgjatjen maksimale të afatit të studimeve, ndërpriten."

## **III. Senati Akademik me Vendim Nr. 25 datë 24. 1. 2025, Nr. 303 Prot. "Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren e punësimit" në USH" ka miratuar këto ndryshime:**

1.1 Në nenin 5, pika 3, në fund të gërme "c", shtohet "si dhe të mes janë në kuht e konfliktit të interesit sipas ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrim e funksioneve publike në fuqi".



1.2 Në nenin 6, në fjalinë e fundit të pikës 2 shtohet: “ose lëndë të përafërta në grupin e lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën korikurohet”.

1.3 Në nenin 6, shtohet pika 3 1, si vijon “ Përfshihet nga krileri i mesatares së cikleve paraardhëse kandidatët për personal akadenimik me kohë të plotë , të kategorisë “Profesor”.

1.4 Në nenin 6, pika 4, togëfjalëshi nivel jo më të ulët C1” zëvendësohet me togëfjalëshin “nivel jo më të ulët se B2”.

1.5 Në nenin 6, pika 8, pas togëfjalëshit “njësitë kryesore” shtohet “me propozim të njësisë bazë” dhe në fund të paragrafit shtohet “Për rastet kur ka kandidat të vetëm në garë me gradën shkencore “Doktor”, njësia bazë me miratim dekanati mund t’i propozojë për miratim Rektorit uljen e nivelit të notës mesatare të përgjithshme të pikës 2 dhe 3, por jo më poshtë se 8”.

1.6 Në nenin 7, termi “rezervë” zëvendësohet me termin “afat”.

1.7 Në neni 9, pika 4, togëfjalëshi “pas shpalljes së afatit të aplikimit”, zëvendësohet me togëfjalëshin “nga data e përfundimit të afatit të aplikimit”.

1.8 Në nenin 11, togëfjalëshi “gjuha e huaj” zëvendësohet me “një nga gjuhët e huaja”. Ndërsa te teksti universitar riformulohet: çdo tekst i nivelit universitar x 10 pikë, miratuar nga njësia akademike e fushës, botuar 5 (pesë) vitet e fundit “.

1.9 Në nenin 12, pika 6, ndryshon si vijon: “Përgjesës për shpalljen e renditjen e kandidatëve fitues është kryetari i komisionit *ad hoc*. Lista e kandidatëve fitues, me gjeneralitetet përkatëse emër/mbiemër, shpallet në faqen zyrtare të USH-së”.

1.10 Në nenin 12, pika 7 ndryshon si vijon: “Në përfundim të konkurimit, drejtori i departamentit, m shkresë përcjellëse të Dekanit dorëzon dosjet e konkurentëve në sektorin e burimeve njerëzore të USH-së. Vendimi i Komisionit përcillet nga Dekani për miratim përfundimtar nga ana e Rektorit.

1.11 Në nenin 15, shtohet pika 4/1, si vijon: “Përfshihen nga krileri i mesatares së cikleve paraardhëse kandidatët për personeli akademik me kohë të pjesshme, të kategorisë “Profesor”.

1.12 Në nenin 15, pika 5, togëfjalëshi “nivel jo më të ulët se 1” zëvendësohet me togëfjalëshin “nivel jo më të ulët se B2”.

1.13 Në nenin 16, te dokumentat e konkurimit, në pikën e deklaratës personale shtohet “si dhe të mroe janë në kushtet e konfliktit të interesit sipas ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në fuqi”.

1.14 Në nenin 19, pika 4, riformulohet si vijon: “Lista e kandidatëve fitues për pedagogë me kohë të pjesshme me gjeneraliteteit përkatëse emër/mbiemër”, shpallet në faqen zyrtare të USH-së, sipas afatit të përcaktuara nga komisioni”.

1.15 Në nenin 20, te vlerësimi i gjuhës së huaj shtohet “një nga gjuhët e huaja (...)”. Ndërsa te teksti i nivelit universitar riformulohet : “çdo tekst i nivelit universitar x 10 pikë, miratuar nga njësia akademike e fushës, botuar 5 (pesë) vitet e fundit”.

1.16 Në nenin 23, pika 1, riformulohet si vijon: “Kandidatët për pozicionet e lira të nivelit ekzekutiv (specialistë dhe pozicione të barazvlefshme me të) duhet të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën përkatëse, në sistemin me kohë të plotë me mesatare jo më të ulët se 7 “ (shtatë). Për të diplomuarit menjëherë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kandidatët për pozicionet e lira të nivelit drejtues, duhet të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën përkatëse, në sistemin me kohë të plotë me mesatare jo më të ulët se 7. 5 (shtatë pikë pesë). Për të diplomuarit menjëherë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria

përgjegjëse për arsimin.

Në nenin 23, në fund të pikës 3 shtohet : “ka aftësi të mira kompjuterike ”.

1.17 Te neni 24, në fund të pikës 6 shtohet “ka aftësi të mira kompjuterike ”.

1.18 Në nenin 25, te dokumentet e konkurimit, në pikën e deklaratës personale shtohet “si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesit sipas ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në fuqi”.

Në nenin 26, te dokumentet e konkurimit, në pikën e deklaratës personale shtohet “si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesit sipas ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në fuqi”.

1.20 Në nenin 29 togfjalëshi jo më vonë se 5 ditë” zëvendësohet me “jo më vonë se 10 ditë”.

1.21 Në nenin 30, pika 3, togfjalëshi “pas shpalljes së afatit të aplikimit” zëvendësohet me togfjalëshin “nga dalja e përfundimit të afatit të aplikimit ”.

1.22 Në nenin 32, pika 2 hiqet “dhe kandidatët që kanë deklarime jo të vërteta në aplikime online”.

1.23 Në nenin 35, pika pesë riformulohet : “Lista e kandidatëve fitues, me gjeneralitetet përkatëse emër/mbiemër”, shpallet në faqen zyrtare të USH-së, ditën e shpalljes së vendimit nga komisioni. Përgjegjës për shpalljen e listës së fituesve është kryetari i komisionit ad hoc”.

1.24 Neni 38, pika 1, riformulohet si vijon: “Kandidatët për pozicionet e lira të nivelit ekzekutiv (specialistë dhe pozicione të barazvlefshme me të) duhet të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën përkatëse, në sistemin me kohë të plotë me mesatare jo më të ulët se 7 (shtatë). Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kandidatët për pozicionet e lira të nivelit drejtues, duhet të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e studimit në fushën përkatëse, në sistemin me kohë të plotë me mesatare jo më të ulët se 7.5 (shtatë pikë pesë). Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse për arsimin”.

Në nenin 38, në fund të pikës 4, shtohet “ka aftësi të mira kompjuterike”.

1.25 Në nenin 39, te dokumentet e konkurimit, në pikën e deklaratës personale shtohet “si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesit sipas ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në fuqi”.

1.26 Në nenin 41, pika 4, togfjalëshi “jo më vonë se 5 ditë” zëvendësohet me jo më vonë se 10 ditë”.

1.27 Neni 44, pika 4, riformulohet “Lista e kandidatëve fitues, me gjeneralitetet përkatëse emër/mbiemër”, shpallet në faqen zyrtare të USH-së, ditën e shpalljes së vendimit nga komisioni. Përgjegjës për shpalljen e listës së fituesve është kryetari i komisionit ad hoc”.

1.28 Në nenin 46, në fund të pikës shtohet togfjalëshi “dhe punëdhënësit”.

1.29 Në nenin 47 shtohet pika 3 si vijon: “Në kategorinë personel akademik i ftuar përfshihen studiues, personalitete, artistë, veridas ose të huaj, të cilët punësohen në USH pa konkurs publik, për një semestër ose një vit akademik. Përsëritja e kontratës bëhet pas vlerësimit të performancës nga departamenti ”.

1.30 Neni 50 riformulohet si vijon: “Kjo rregullore mund të ndryshohet me kërkesë të tifullarit të institucionit ose me kërkesë të 1/ 3 (një e treta) të anëtarëve të Senatit Akademik të USH-së.

1.31 Të riformulohen skedat e vlerësimeve sipas neneve përkatëse.

1.32 Të bëhet numërimi i plotë i neneve.



1.33 Të zëvendësohet në të gjithë tekstin e rregullores togfjalëshi “shkollë e lartë” me togfjalëshin “institucion i arsimil të lartë”.

1.34 Të zëvendësohet në të gjithë tekstin togfjalëshi “drejtor departamenti” me togfjalëshin “drejtues departamenti”.

**IV. Senati Akademik me Vendim Nr. 57 datë 21. 02. 2025, Nr. 770 Prot. “Për miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” miratoi ndryshimet si më poshtë:**

- Në nenin 8 të Statutit të USH-së, të shtohet pika 3, me këtë përmbajtje: Organigrama e USH-së. përcaktohet në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij statuti.

- Në pikën 5, të nenit 9, të Statutit të USH-së, emërtimi: (Fakulteti i Shkencave Natyrore), korrigjohet dhe unifikohet në: (Fakulteti i Shkencave të Natyrës).

- Pika 6, e nenit 9, i Statutit të USH-së, të riformulohet si vijon: Përbërja e fakulteteve përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur statutit dhe në rregulloret e tyre.

Nr 109 datë 27.03.2025.

**V. Senati Akademik me Vendim Nr. 109 datë 27. 03. 2025, Nr. 183 Prot. “Për disa shtesa në Rregulloren e studimeve në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” miratoi këto ndryshime:**

1. Në nenin 14, të rregullores, pas pikës 5, të shtohet pika 6. si vijon:

"6. Përfshihen nga rregullat detyruese të përcaktuara nga pikat I deri në pikën 5 të këtij neni. studentët e rregullt që ndjekin studimet semestrale Erasmus+: CEEPUS dhe programe të tjera të ngjashme, bazuar në marrëveshjet institucionale ku USH është palë (Learning Agreement).

2. Në nenin 31, të rregullores, pas pikës 4, të shtohet pika 5, si vijon:

"5. Studentët e rregullt që ndjekin studimet semestrale Erasmus+: CEEPUS dhe programe të tjera të ngjashme, bazuar në marrëveshjet institucionale ku USH është palë (Learning Agreement). hyjnë në riprovimet e të njëjtit vit me 100 pikë."

**VI. Senati Akademik me Vendim Nr. 137 datë 28. 04. 2025, Nr. 1612 Prot. “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.**

*b.Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë funksionon Sektori i Sigurimit të Cilësisë*

**Tabela 8. Mbi veprimtarinë e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë**

| Nr. | Aktiviteti / Veprimtaria | Zyra e Sigurimit të Cilësisë / Përbërja              | Periudha Kohore | Rezultati / Produkti |
|-----|--------------------------|------------------------------------------------------|-----------------|----------------------|
|     |                          | Dr. Ermira Ymeraj<br>(përgjegjës SSC)<br>Olta Smajli |                 |                      |

|            |                                                                                                                                                                 |                                                 |                               |                                                                                                                                                          |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|-------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            |                                                                                                                                                                 | (raportuese në ASCAL)                           |                               |                                                                                                                                                          |
| <b>1.</b>  | Raportim në ASCAL për programet e reja të studimit.                                                                                                             | Olta Smajli (raportuese në ASCAL)               | tetor 2024-shtator 2025       | Raporte me të dhëna mbi programet e reja dhe të riorganizuar.<br><br>Plotësim i sistemit ams ASCAL me të dhëna mbi stafin akademik dhe studentët në USH. |
| <b>1.1</b> | Aplikimi për Akreditimin e 13 programeve Bachelor.                                                                                                              | Olta Smajlaj                                    | 6 tetor 2024                  | Pagesa e shqyrtimit për secilin program                                                                                                                  |
| <b>1.2</b> | Ndjekja dhe shqyrtimi i vendimarrjes së departamenteve në lidhje me raportet e analizës së pyetësorit të pedagogëve "Formular vlerësimi nga personeli akademik" | Dr. Ermira Ymeraj<br>Olta Smajli                | 26.08. 2025 deri më 8.10.2025 | Raport analitik me gjetje kryesore dhe plan masash për secilin program.                                                                                  |
| <b>1.3</b> | Ditët informuese me studentët. Informim mbi rëndësinë e pyetësorëve dhe mënyrën e plotësimit.                                                                   | Spektori i Sigurimit të Cilësisë                | tetor 2024                    | Studentë të informuar                                                                                                                                    |
| <b>2.</b>  | Menaxhimi i zhvillimit të pyetësorit për "Lëndën, modulin dhe pedagogun" për të gjithë studentët e USH-së për dy semestra                                       | Zv. Dekanë; Dr. Ermira Ymeraj, Msc. Olta Smajli | Janar 2024-Shtator 2024       | Analizë sasiore dhe përshkruese e përgjigjeve të studentëve sipas fakulteteve.                                                                           |
| <b>2.1</b> | Menaxhimi i zhvillimit të Fokus grupeve me gjithë studentët e 13 programeve në proces akreditimi për vitin akademik 2024 - 2025.                                | Dr. Ermira Ymeraj, Msc. Olta Smajli             | Prill 2024 - Shtator 2024     | Analizë sasiore dhe përshkruese e përgjigjeve të studentëve sipas fakulteteve                                                                            |
| <b>2.2</b> | Menaxhimi i zhvillimit të pyetësorit për pedagogun,                                                                                                             | Dr. Ermira Ymeraj, Msc. Olta Smajli             | 11.02. 2025 deri më           | Analizë sasiore dhe përshkruese e                                                                                                                        |

|     |                                                                                                    |                                                                                                                    |                               |                                                                                                                       |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | “Vetëvlerësimi i lëndës nga pedagogu”                                                              |                                                                                                                    | 28.02.2025                    | përgjigjeve të pedagogëve sipas fakulteteve.                                                                          |
| 2.3 | Analiza dhe reflektimet mbi pyetësin. “Tabelë me të dhëna mbi veprimtarinë akademike të pedagogut” | Dr. Ermira Ymeraj, Msc. Olta Smajli                                                                                | 26.08. 2025 deri më 8.10.2025 | Analizë sasiore dhe përshkuese e përgjigjeve të studentëve sipas fakulteteve.                                         |
| 3.  | Zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve për vitin akademik 2024-2025                         | Zv. Rektori akademik, drejtori i IT, Sektori i marrëdhënieve me studentët, Këshilli Studentor, Raportuesi me ASCAL | janar 2024- maj 2024          | Plotësimi i sondazhit në masë nga studentët e USH-së.                                                                 |
| 4.  | Menaxhimi i raporteve për kodifikimin e programeve të studimit.                                    | Olta Smajli (raportuese në ASCAL) Zyra e ALUMN-it në USH.                                                          | Tetor 2024                    | Përgjigjet e pyetësorit dërgohen në kohë reale në platformën e krijuar (google forms) nga ASCAL për mbledhjen e tyre. |
| 5.  | Tërheqja e certifikatave të programeve të studimit dhe institucioneve të akredituara.              | Olta Smajli (raportuese në ASCAL)                                                                                  |                               | Arkivimi i certifikatave për 10 programet e studimit.                                                                 |

#### Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

| Nr. | Aktiviteti / Veprimtaria          | Grupi i Vlerësimit të Brendshëm / Përbërja                                                                                                                                                                                                                                                    | Periudha Kohore | Rezultati / Produkti                                                                      |
|-----|-----------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.  | Raportit të cilësisë së brendshme | 1. Prof. dr. Mimoza Priku - Kryetar<br>2. Prof.as dr. Alva Dani (FGJH)-Anëtar<br>3. Prof.as.dr. Ardita Boriçi (FE)-Anëtar<br>4. Prof.as.dr. Emanuela Furramani (FD)-Anëtar<br>5. Dr. Nevila Bushati (FSHN)-Anëtar<br>6. Dr. Dritan Rustja (FSHS)-Anëtar<br>7. Dr. Arlinda Ymeri (FSHE)-Anëtar | dhjetor 2024    | Përmirësim dhe miratim i “Raportit të cilësisë së brendshme për vitin akademik 2024-2025” |

|    |                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                          |                      |                                                                             |
|----|----------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
|    |                                                                            | 8. Manjola Lulaj (Spec. e ALUMNI)-Anëtar<br>9. Dr. Ermira Ymeraj (përgjegjës SSC)-Anëtar<br>10. Olta Smajli (spec. SSC)-Anëtar<br>11. Prof. dr. Gëzim Dibra (Ekspert i jashtëm)-Anëtar<br>12. Arba Lohja (Student, Msc.)-Anëtar<br>13. Ambra Hysa (Student, Msc.)-Anëtar |                      |                                                                             |
| 2. | Rregullore e funksionimit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë |                                                                                                                                                                                                                                                                          | shkurt 2025-maj 2025 | Hatimi i draft-rregullores së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë |

f-Parashikimi për angazhimin e personelit akademik, ngarkesa përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre, për secilin semestër të vitit akademik.

#### **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**

Në Departamentin e Gjuhësisë ngarkesa mësimore është përballuar e gjitha nga pedagogët e brendshëm, pa qenë nevoja të rekrutohet personel i ri akademik.

Departamenti i Gjuhësisë gjatë vitit 2024-2025 ka vijuar të ketë 8 anëtarë, ku i gjithë stafi është i gjinisë femërore, të fashës moshore mbi 40 – nën 60 vjeçare. Në përbërje ka 1 pedagog me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i asociuar”, 4 kanë gradën shkencore “Doktor” dhe 1 “Docent”. (Shih tabelën nr. 9)

Në Departamentin e Letërsisë ngarkesa mësimore është përballuar nga pedagogët e brendshëm të departamentit dhe 1 pedagog i jashtëm. Ndërkohë që në fund të semestrit të dytë është rekrutuar edhe 1 pedagog i brendshëm për programin Gazetari dhe komunikim. Ky departament gjatë vitit 2024-2025 ka pasur në përbërjen e tij 9 anëtarë, 6 të gjinisë mashkullore dhe 3 të gjinisë femërore, shumica mbi moshën 50 vjeçare. Në përbërje ka 1 pedagog me titullin “Profesor”, 5 me titullin “Profesor i asociuar”, 2 kanë gradën shkencore “Doktor” dhe 1 Msc. (Shih tabelën nr 9)

Në Departamentin e Historisë ngarkesa mësimore është përballuar nga pedagogët e brendshëm të departamentit dhe 2 pedagogë të jashtëm. Personeli i brendshëm akademik i departamentit të Historisë gjatë vitin akademik 2024-2025, përbëhet nga 7 anëtarë (4 femra e 3 meshkuj), prej të cilëve 1 “Profesor”, 2 “Profesor i asociuar”, 3 “Doktorë” dhe 1 “Doktorant”. Këtë vit akademik është rikthyer edhe 1 pedagog me gradën shkencore “Doktor”. (Shih tabelën)

Në Departamentin e Gjeografisë ngarkesa mësimore është përballuar nga pedagogët e brendshëm të departamentit dhe 5 pedagogë të jashtëm. Personeli i brendshëm akademik i departamentit të

Gjeografisë gjatë vitin akademik 2024-2025, përbëhej nga 7 anëtarë (3 femra e 4 meshkuj) prej të cilëve 2 “Profesorë të asociuar”, 5 “Doktorë”.

### **Fakulteti i Shkenave të Edukimit**

Në programet e studimeve të nivelit të parë Bachelor në Psikologji dhe në Punë Sociale, si dhe në ciklin e dytë Master Profesional në Shërbime Sociale, mbulimi i ngarkesës nga pedagogë të brendshëm (të DPPS apo të departamenteve të tjera të USH) ka qenë në përputhje me Udhëzimet e MAS duke e kaluar pragun prej 70%, konkretisht Bachelor në Psikologji 71.4%, Bachelor në Punë Sociale 72.8%, Master Profesional Shërbime Sociale 90.9%. Ndërsa mbetet shqetësues mbulimi me staf të brendshëm në programet e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji Klinike ku nuk plotësohet kriteri prej 70%, konkretisht 67.2% e programit mbulohet me staf të brendshëm, ndërsa në rastin e programit Master i Shkencave në Psikologji Organizative vetëm 54.1% e ngarkesës mbulohet nga staf i brendshëm.

Në programet e studimeve të nivelit të parë Bachelor në Mësuesi për “Arsimin Fillor”, Bachelor në Mësuesi për “Arsimin parashkollor”, si dhe në ciklin e dytë Master profesional në Mësuesi për “Arsimin Fillor” dhe Master profesional në Mësuesi në “Pedagogji Speciale” mbulimi i ngarkesës nga pedagogë të brendshëm (të DM apo të departamenteve të tjera të USH) ka qenë në përputhje me Udhëzimet e MAS duke e kaluar pragun prej 70%, konkretisht Bachelor në Mësuesi për “Arsimin Fillor” 78.6%, Bachelor në Mësuesi për “Arsimin Parashkollor” 72% , Master Profesional në Mësuesi për “Arsimin Fillor” 89.3% dhe Master profesional në Mësuesi në “Pedagogji Speciale” 73%

Në programet e studimeve të nivelit të parë Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, sipas raportit të departamentit të Edukimit Fizik e Sporte, mbulimi i ngarkesës me staf të brendshëm nuk ka qenë në përputhje me udhëzimet e MAS, pra nuk plotëson kriterin e 70%, konkretisht 67%, ndërsa ciklin e dytë Master Profesional në Mësuesi për “Edukim fizik dhe Sporte”, kriteri 70% tejkalohet dhe konkretisht 94 % e programit mbulohet me staf të brendshëm.

Në programet e studimit të nivelit të parë, Bachelor në Pikturë dhe Grafikë dhe Pedagogji Muzikore, si dhe në ciklin e dytë, Master Profesional në Mësuesi i Artit Pamor, mbulimi i ngarkesës mësimore nga pedagogë të brendshëm (të DA apo të departamenteve të tjera të USH) është realizuar në përputhje me udhëzimet e MAS, duke tejkaluar pragun prej 70%. Megjithatë, mbulimi me staf të brendshëm në programet e ciklit të dytë, Master Profesional Mësues Muzike, mbetet sfidues, pasi nuk plotësohet kriteri i kërkuar prej 70%.

### **Fakulteti i Drejtësisë**

Në lidhje me mbulimin e ngarkesave mësimore nga stafi akademik me kohë të plotë, mund të themi që përcaktimi i tyre është bërë me vendim nga secili Departament në përputhje me legjislacion në fuqi. Në disa raste, për shkak të nevojave të Fakultetit për mbulimin e orëve mesimore të disa lëndëve, ka lindur nevoja që disa pedagogë të kenë në ngarkesë mësimore orë suplementare specifike.

### **Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

Gjatë vitit akademik 2024-2025 FGJH ka numëruar si staf akademik me kohë të plotë 24 pedagogë. Ngarkesa e plotë e planeve mësimore që ofron FGJH është realizuar 100% duke respektuar

dakortësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional midis FGJH dhe Fakulteteve të tjera të USH-së (FSHE, FSHSH dhe FE).

Personeli i brendshëm i stafit të Departamentit të Romanistikës gjatë vitit akademik 2024-2025 kishte në përbërje të vet 10 anëtare, prej të cilave 5 anëtare i përkasin kategorisë "Profesor", 4 anëtare i kategorisë "Lektor" dhe 1 anëtare i përkasin kategorisë 'As. lektor'.

Mbulimi në përqindje nga stafi i brendshëm ka qenë si vijon:

-Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Italiane dhe Gjuhë Frënge është mbuluar mbi masën 70 % nga staf i brendshëm.

-Programet e studimit Master në Mësuesi në Gjuhë Italiane dhe Master në Mësuesi në Gjuhë frënge janë mbuluar 100% nga stafi i brendshëm.

Për plotësimin e nevojave për realizimin e plotë të ngarkesës së parashikuar në programin e studimit Bachelor në Gjuhë italiane u angazhuan nga departamente të fakulteteve të USH-së: 1 (një) pedagog nga Departamenti i Turizmit, 2 (dy) pedagoge nga Departamenti i Gjuhës Shqipe, 1 (një) pedagoge nga Departamenti i Gjermanistikës. Si staf i jashtëm, për këtë program studimi u angazhuan 1 (një) pedagoge me kontratë me kohë të pjesshme.

Për plotësimin e nevojave për realizimin e plotë të ngarkesës së parashikuar në programin e studimit Bachelor në Gjuhë frënge Master në Mësuesi në Gjuhë frënge u angazhuan pedagogë nga departamente të fakulteteve të USH-së: 2 (dy) pedagoge nga Departamenti i Gjuhës Shqipe, 1 (një) pedagoge nga Departamenti i Letërsisë, 1 (një) pedagoge nga Departamenti i Gjermanistikës. Gjithashtu përmendim edhe pedagogët e brendshëm të FSHE- së të cilët mbulojnë në programet master lëndët përkatëse bazuar në marrëveshjen mes dy fakulteteve.

Plani mësimor i programeve të studimit të këtij departamenti, për vitin akademi 2024-2025, është realizuar në masën 100%.

Departamenti i Gjuhës Angleze përbëhet nga 7 anëtare, prej të cilave 3 anëtare i përkasin kategorisë Profesor", 4 anëtare i përkasin kategorisë "Lektor".

Mbulimi në përqindje nga stafi i brendshëm ka qenë si vijon:

-Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Angleze mbulohet në masën 95% nga stafi i brendshëm.

-Programi i studimit Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Angleze mbulohet në masën 100% nga stafi i brendshëm.

Për realizimin e plotë të ngarkesës së parashikuar në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, nga fakultete të USH-së u angazhuan: 2 pedagogë nga Departamenti i Gjuhës Shqipe, 2 pedagogë nga Departamenti i Letërsisë dhe Gazetari/Komunikim dhe 1 pedagogë nga Departamenti i Romanistikës.

Pedagogë të jashtëm që u angazhuan për këtë program studimi janë: 1 pedagog u angazhua nga Qendra Turke Yunus Emre në bazë të marrëveshjes me USH dhe 1 pedagog për mbulimin e gjuhës malazeze si lëndë me zgjedhje, viti i III Ba.

Në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën Amerikane në Shqipëri, u atashua për mbështetje akademike dhe kulturore Msc. Marissa Fotti. Atashimi i saj për një vit akademik kishte si qëllim jo vetëm që kultura dhe gjuha 'american english' të përcillej nga një 'native speaker', por më tepër prania e pedagoges në fjalë është tregues i forcimit të marrëdhënieve dhe i mbështetjes që kjo

ambasadë i ofron Departamentit të Gjuhës Angleze.

Për programin e studimit Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Angleze u angazhuan pedagogë të brendshëm të FSHE- së të cilët mbulojnë lëndët përkatëse bazuar në marrëveshjen mes dy fakulteteve.

Plani mësimor i programeve të studimit të këtij departamenti, për vitin akademik 2024-2025, është realizuar në masën 100%.

Personeli i brendshëm i Departamentit të Gjermansitikës është përbërë gjatë vitit akademik 2024-2025 nga 7 anëtarë, prej të cilëve 2 anëtarë i përkasin kategorisë 'Profesor' dhe 5 anëtarë kategorisë 'Asistent-Lektor'. Ndërkohë për mbulimin e orëve të programeve të studimit që ofron njësia bazë si p.sh. lëndët Gjuhë shqipe dhe Lëndë me zgjedhje, janë mbuluar nga stafi i brendshëm i Departamentit të Gjuhës, i Letërsisë dhe i Romanistikës, përkatësisht departamente të FSHSH-së dhe FGJH-së. Po ashtu për mbulim e lëndës 'Praktikë Profesionale' janë rekrutuar dy pedagogë të jashtëm. Për mbulimin e orëve 'Gjuhë e huaj Gjermanisht' në programe të ndryshme studimi është rekrutuar 1 anëtarë me kohë të pjesshme, rekrutim i bërë në bazë të aplikimit online dhe më pas komisioni ad/hoc ka bërë rankimin mbështetur në kriteret për zënien dhe ruajtjen e vendit për lektorët me kohë të pjesshme.

Gjithashtu përmendim edhe pedagogët e brendshëm të FSHE- së të cilët mbulojnë në programet master lëndët përkatëse bazuar në marrëveshjen mes dy fakulteteve.

Plani mësimor i programeve të studimit të këtij departamenti, për vitin akademik 2024-2025, është realizuar në masën 100%.

#### **Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik**

#### **Fakulteti i Shkencave Shoqërore**



SHËRBENDARIA E ORËVE VJETORE TË PUNËS, PËR VITIIN AKADEMIK

| N | Emri Mësimtar    | Pozicioni i punës / grada                     | Mësimdhënia                                            |                   |          |          |                                               |                                       |                                    |                         |                                |                          |                             |                                                            | Veprimtari në mbledhjet e tërësishme të mësimdhënies |                                         |                                   |                                         | Shuma e orëve vjetore të punës |                                       |                                                                                                               |
